



PROGRAMI I REMITANCAVE DHE PAGESAVE NË SHQIPËRI – FINANCUAR NGA SECO

# NJË PASQYRË E TREGUT TË REMITANCAVE NË SHQIPËRI

Raport vlerësimi bazuar në Parimet e Përgjithshme për Shërbimet e Remitancave Ndërkombëtare - Komiteti i Pagesave dhe Infrastrukturave të Tregut (CPMI), Banka Botërore

Grupi i Zhvillimit të Sistemeve të Pagesave  
Janar 2017

## Përmbajtja

Akronime dhe Shkurtime .....	2
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
RAPORT .....	7
Hyrje.....	7
Vështrim i përgjithshëm.....	10
Komiteti i Pagesave dhe Infrastrukturave të Tregut- Vlerësimi i Bankës Botërore sipas Parimeve të Përgjithshme .....	16
Parimi i Përgjithshëm 1: Transparenca dhe Mbrojtja e Konsumatorit .....	16
Parimi i Përgjithshëm 2: Infrastruktura e sistemeve të pagesave .....	20
Parimi i Përgjithshëm 3: Mjedisi Ligjor dhe Rregullativ .....	26
Parimi i Përgjithshëm 4: Struktura e tregut dhe Konkurrenca .....	31
Parimi i Përgjithshëm 5: Qeverisja dhe Menaxhimi i Rrezikut .....	34
Roli i Ofruesve të Shërbimeve të Remitancave .....	36
Roli i Autoriteteve Publike .....	38
I.    PLANI I PROPOZUAR PËR VEPRIM DHE HAPAT E MËTEJSHËM.....	40

## Akronime dhe Shkurtime

ACH	<i>Automated Clearing House</i> - Shtëpi Klerimi e Automatizuar
AAB	<i>Association of Albanian Banks</i> - Shoqata Shqiptare e Bankave
AECH	<i>Albanian Electronic Clearing House</i> - Sistemi Shqiptar i Klerimit të Pagesave me Vlerë të vogël
AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
AIPS	<i>Albanian Interbank Payments System</i> - Sistemi Shqiptar i Pagesave Ndërbankare me Vlerë të Madhe
PPP - AML	Parandalimi i Pastrimit të Parave - <i>Anti Money Laundering</i>
ATM	<i>Automated Teller Machine</i> - Bankomat
BIS	<i>Bank for International Settlements</i> – Banka për Rregullime Ndërkombëtare
BSH - BoA	Banka e Shqipërisë - <i>Bank of Albania</i>
CDD	<i>Customer Due Diligence</i> – Kujdesi i Duhur ndaj Klientit
LFT - CFT	Lufta kundër Financimit të Terrorizmit - <i>Combating the Financing of Terrorism</i>
KMK - CPC	Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit - <i>Consumer Protection Commission</i>
CPMI	<i>Committee on Payments and Market Infrastructures</i> - Komiteti i Pagesave dhe Infrastrukturave të Tregut (CPMI)
CPSS	<i>Committee on Payment and Settlement Systems</i> – Komiteti i Sistemeve të Pagesave dhe Shlyerjes
EFTPOS	<i>Electronic Funds Transfer at Point of Sale</i> – Transfertë Elektronike e Fondeve tek Pika e Shitjes
BE - EU	Bashkimi Evropian - <i>European Union</i>
UFT - FUT	Unioni Financiar Tiranë - <i>Financial Union Tirana</i>
DPPP	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
PPB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
GP	Parimet e Përgjithshme për Shërbimet e Remitancave Ndërkombëtare - Banka Botërore – Komiteti i Pagesave dhe Infrastrukturave të Tregut
KYC	<i>Know Your Customer</i> - Njihni Klientin Tuaj
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
MZHTS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
MB	Ministria e Brendshme
MIAP	Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike
OTP	Operator për Transferimin e Parave
IFJB	Institucione Financiare Jobanka
KKSP	Komiteti Kombëtar i Sistemeve të Pagesave
SKP	Sistemi Kombëtar i Pagesave
POS	<i>Point of Sale</i> – Pikë Shitje
PAFI	<i>Payment Aspects of Financial Inclusion</i> – Aspekte të Pagesave në kuadër të Përfshirjes Financiare
PSDG	<i>World Bank Payment Systems Development Group</i> – Grupi i Bankës Botërore për zhvillimin e Sistemeve të Pagesave
PSD1	<i>European Commission Directive on Payment Services</i> – Direktiva e Shërbimeve të Pagesave të Komisionit Evropian
PSD2	<i>European Commission Revised Directive on Payment Services</i> - Direktiva e Rishikuar e Shërbimeve të Pagesave të Komisionit Evropian
PRP	Programi i Remitancave dhe Pagesave
RPW	<i>Remittance Prices Worldwide</i> – Çmimet (Kostot) Botërore të Remitancave

RSP	<i>Remittance Service Provider</i> – Ofrues i Shërbimit të Remitancave
RTGS	<i>Real Time Gross Settlement</i> – Shlyerje në vlerë bruto në kohë reale
SHKK	Shoqëri Kursim-Krediti
SDG	<i>Sustainable Development Goals</i> – Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm
SECO	<i>State Secretariat for Economic Affairs of Switzerland</i> – Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike të Zvicrës
BB	Banka Botërore

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- i. Në janar 2007, Banka Botërore dhe Komiteti për Sistemet e Shlyerjes dhe Pagesave – tashmë, Komiteti i Pagesave dhe Infrastrukturave të Tregut – në Bankën për Rregullime Ndërkombëtare (BIS) publikoi Parimet e Përgjithshme për Shërbimet e Remitancave Ndërkombëtare, që në vazhdim do të referohen si “Parimet e Përgjithshme”. Parimet e Përgjithshme përcaktojnë udhëzime dhe praktikat më të mira për tregje eficiente të remitancave, të cilat janë miratuar edhe nga organizata të ndryshme ndërkombëtare, përfshirë Forumin për Stabilitetin Financiar dhe grupin e vendeve G8 dhe G20. Në Samitin e Kanës, në vitin 2011, vendet e G20 miratuan një objektiv sasior për të reduktuar koston (çmimin) mesatare globale të remitancave (dërgesave) (matur nga Databaza Botërore për Kostot e Remitancave, e Bankës Botërore, “RPW”) në 5% deri në vitin 2014 dhe një listë të masave që vendet e G20 duhet të ndërmarrin për të mbështetur këtë objektiv (*the Remittance Toolkit*). Sikurse nismat e tjera, *the Remittance Toolkit* u rekomandon vendeve të vlerësojnë nëse tregu i tyre kombëtar i remitancave përputhet me rekomandimet e Parimeve të Përgjithshme.
- ii. Bazuar në Programin e Remitancave dhe Pagesave të financuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike të Zvicrës (SECO), pesë specialistë nga Grupi i Bankës Botërore për Zhvillimin e Sistemeve të Pagesave, vizituan Shqipërinë në datat 13-16 shtator 2016 për të mbledhur informacion me qëllim përgatitjen e një pasqyre të tregut të remitancave<sup>1</sup> bazuar në Parimet e Përgjithshme dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësime të mundshme. Grupi i Bankës Botërore drejtohej nga z. Carlo Corazza (Specialist i lartë i Pagesave dhe Remitancave), dhe përfshinte z. Nenad Bosiljčić (Konsulent, Koordinator Rajonal i Programit të Remitancave dhe Pagesave), znj. Elisabetta Cervone (Konsulente, Specialiste e Lartë Ligjore) dhe z. Jose Antonio Garcia (Konsulent, Këshilltar i Lartë i Sistemeve të Pagesave)<sup>2</sup>. Paralelisht, ky grup pune realizoi edhe vlerësimin e aspekteve të pagesave në kuadër të përfshirjes financiare, bazuar në Raportin e Komitetit të Pagesave dhe Infrastrukturave të Tregut të Bankës Botërore (CPMI-WB). Meqenëse këto vlerësime u realizuan në të njëjtën kohë dhe përfshinin të njëjtat çështje si kuadri ligjor, infrastruktura e pagesave etj., disa vëzhgime dhe rekomandime përkojnë me njëra-tjetrën, pavarësisht se të trajtuara në këndvështrime të ndryshme.
- iii. Remitancat (dërgesat) janë shumë të rëndësishme për Shqipërinë. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, jashtë Shqipërisë jetojnë rreth 1.3 milion emigrantë, që përbëjnë 40% të popullsisë aktuale që jeton brenda kufijve<sup>3</sup>. Ata janë kryesisht të vendosur në Itali, Greqi, Gjermani dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Disa komunitete të vogla gjenden edhe në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Austri, Kanada, Francë, Rumani, Belgjikë, Rusi, rajonin Skandinav, Zvicër, Ukrainë dhe Mbretërinë e Bashkuar. Vlera e dërgesave që hynë në Shqipëri vlerësohet të jetë e barabartë me 8.5% të Prodhimit të Brendshëm Bruto të vendit për vitin 2014, që përketet afërsisht në vlerën 1.1 miliardë usd<sup>4</sup>.
- iv. Sipas Vrojtimit Bazë të Grupit të Bankës Botërore për sjelljen financiare<sup>5</sup> të përfituesve të remitancave në Shqipëri, pjesa më e madhe (57%) e dërgesave vlerësohet të arrijë në Shqipëri nëpërmjet Operatorëve të

<sup>1</sup> Sipas Parimeve të Përgjithshme, remitancat ndërkombëtare përkufizohen si pagesa ndërkufitare person me person në vlera relativisht të vogla, që në mënyrë tipike janë të përsëritura. Remitancat zakonisht janë dërgesa të punonjësve emigrantë ndaj familjeve të tyre në vendin e origjinës.

<sup>2</sup> Ky mision u mbështet në distancë edhe nga zj. Maria Teresa Chimienti (Specialiste e Lartë e Sistemeve të Pagesave).

<sup>3</sup> Banka Botërore, 2015.

<sup>4</sup> Llogaritjet e stafit të BB-së bazohen në të dhënat e marra nga databaza e FMN-së për Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe nga të dhëna të publikuara nga bankat qendrore, agjencitë kombëtare të statistikave dhe tryezat e punës së Grupit të Bankës Botërore, Tetor 2014.

<sup>5</sup> Vrojtimi bazë për sjelljen financiare të përfituesve të remitancave është realizuar nga Grupi I Bankës Botërore në gjashtë vende të rajonit të Evropës dhe Azisë Qendrore: Serbi, Shqipëri, Kosovë, Taxhikistan, Republikën e Kirgistanit dhe Bosnja Hercegovina, në vitin 2016.

Transferimit të Parave (OTP), ndërsa 37% e transfertave nëpërmjet transportit fizik të parave ndërmjet kufijve. Pjesa e mbetur kanalizohet nëpërmjet bankave (4%) dhe Postës Shqiptare (1%).

- v. Dërgimi i një vlere ekuivalente me 200 USD në Shqipëri kushton 9.39% krahasuar me koston globale prej 7.4% dhe atë rajonale prej 7.25%. Kostoja mesatare më e lartë e dërgimit të parave në Shqipëri është nga Zvicra (15.34%), ndërsa ajo më e ulët nga Italia (7.4%). Dërgesat nga Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar për në Shqipëri kushtojnë mesatarisht 9.23 dhe 9.66%, respektivisht<sup>6</sup>.
- vi. Tarifat e shërbimeve dhe kurset e këmbimit janë zakonisht të afishuara në ambientet ku ushtrojnë aktivitet ofruesit e shërbimeve të remitancave dhe klientët informohen rreth kushteve të shërbimeve përpara se të kryejnë transaksionin. Zakonisht ky informacion është verbal, por mund të ofrohet edhe nëpërmjet njoftimeve apo fletëpalosjeve, si dhe gjendet në mandatat e pagesave. Megjithatë, nuk ekziston ndonjë ligj specifik në fushën e transparencës dhe mbrojtjes së konsumatorit për shërbimet financiare, përfshirë pagesat dhe remitancat. Për momentin, kuadri ligjor i përshtatshëm përbëhet nga rregulloret, dhe nuk ka ndonjë autoritet të përcaktuar për të imponuar këto rregulla.
- vii. Kuadri ligjor dhe rregullativ për shërbimet dhe sistemet e pagesave është i shëndoshë, pra përfshin të gjitha konceptet bazë që mbështesin operacionet e sigurta dhe efikase të sistemeve të pagesave. Në një farë mase, ky kuadër përshtatet edhe me inovacionin në fushën teknologjike dhe modelin e biznesit për pagesat me vlerë të vogël. Për shembull, paraja elektronike (*e-money*) u rregullua nga pikëpamja rregullative dhe ligjore në vitin 2011 nëpërmjet përjashtimit të parasë elektronike nga koncepti i depozitës bankare nga “Ligji për Bankat në Republikën e Shqipërisë”. Modelet e bazuara në agjentë mund të përdoren nga institucionet financiare jobanka. Megjithatë, emetimi i parasë elektronike (*e-money*) konsiderohet si një aktivitet financiar dhe prandaj lejohet vetëm për bankat dhe institucionet financiare jobanka. Gjithashtu, kuadri rregullativ për nënkontraktimin e palëve të treta (*outsourcing*)/agjentët nuk është gjithëpërfshirës: për shembull, nuk ka dispozita që lejojnë përdorimin e agjentëve nga bankat.
- viii. Infrastruktura e pagesave në Shqipëri është moderne dhe e besueshme, pavarësisht se mungojnë disa elemente dhe mbulimi i pikave të aksesit është i kufizuar. BSH-ja administron dhe operon dy sisteme të pagesave<sup>7</sup>: Sistemin Shqiptar të Pagesave Ndërbankare (AIPS - *Albanian Interbank Payments System*) dhe Sistemin e Klerimit të Pagesave me Vlerë të Vogël (AECH - *Albanian Electronic Clearing House*). Pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në sistem mund të jenë vetëm bankat, ndërsa kriteret për pjesëmarrjen e tërthortë janë të paqarta. Ekziston një përpjekje për zhvillimin e një platforme për përpunimin e kartave të pagesave por është ende në fazat fillestare. Megjithatë, në një masë të madhe, ndërveprimi i pikave të shitjes (POS) dhe infrastrukturës së ATM-ve (bankomateve) është bërë i mundur nga rrjetet globale Visa dhe MasterCard. Nga ana tjetër, depërtimi i ATM-ve dhe POS-eve në Shqipëri është më i ulëti në rajonin e Ballkanit Perëndimor.
- ix. Western Union dhe Money Gram, dy operatorët më të mëdhenj ndërkombëtarë për transferimin e parave (OTP), dominojnë në ofrimin e shërbimeve të remitancave në Shqipëri (përfshirë edhe nëpërmjet bankave që veprojnë si agjentë të MTO-ve). Këta dy ofrues të shërbimeve të remitancave veprojnë si një duopol, duke bërë që i gjithë fluksi i remitancave të përqendrohet tek OTP-të. Të tjerë operatorë ndërkombëtarë të transferimit të parave kanë filluar të operojnë në vend, në bashkëpunim me bankat dhe institucionet financiare jobanka dhe po zgjerojnë me shpejtësi praninë e tyre në Shqipëri, duke shfrytëzuar teknologjitë e reja dhe instrumentet inovative të pagesave. Ekzistojnë raste të kushteve të ekskluzivitetit të aplikuara nga disa ofrues të caktuar tek agjentët e tyre. Kjo praktikë zakonisht aplikohet për të reduktuar konkurrencën dhe mund të jetë një faktor që ndikon në kostot e larta të shërbimit të remitancave (dhe në rritjen e përdorimit të kanaleve të parregulluara/joformale). Të drejtat jo të barabarta të aksesit në sistemet e pagesave – sikurse u përmend më

<sup>6</sup> Çmimet (Kostot) Botërore të Remitancave, Tremujori IV 2016.

<sup>7</sup> Banka e Shqipërisë operon edhe sistemin e shlyerjes së titujve - AFISaR.

lart – mund të jenë gjithashtu një faktor në kufizimin e konkurrencës për ofrues të tillë, si institucionet jobanka.

- x. Flukset hyrëse të remitancave<sup>8</sup> disbursohen pothuajse ekskluzivisht në *cash* (para të gatshme). Kjo situatë ekziston për shkak të kombinimit të disa faktorëve: (i) bankat nuk bashkëpunojnë me OTP-të për të mundësuar disbursimin e remitancave në llogaritë bankare, e shoqëruar me (ii) OTP-të nuk i kërkojnë në mënyrë aktive mundësitë për bashkëpunim sepse e perceptojnë kërkesën e konsumatorëve si të pamjaftueshme dhe përfitueshmërinë të ulët. Besimi i kufizuar në sektorin bankar dhe nivelet e ulëta të kulturës financiare mund të jenë gjithashtu faktorë që pengojnë "bankarizimin" e pritësve të remitancave. Kjo është një mundësi e humbur për të promovuar aksesin dhe përfshirjen financiare më gjerësisht (nëpërmjet shitjeve të produkteve të tjera financiare).
- xi. Banka e Shqipërisë ka kompetencat e duhura rregullative dhe mbikëqyrëse për të monitoruar dhe kontrolluar rrezikun në tregun e shërbimeve të pagesave dhe remitancave. Ligji "Për Bankën e Shqipërisë"<sup>9</sup>, Ligji "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligji "Për sistemin e pagesave", përcaktojnë përgjegjësitë e Bankës së Shqipërisë për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave, përfshirë emetimin dhe përdorimin e instrumenteve të pagesave. Kërkesat rregullative të përcaktuara parashikojnë që institucionet financiare jobanka të implementojnë një sistem administrimi të rrezikut bazuar në një vlerësim të natyrës, vëllimit dhe kompleksitetit të aktivitetit të tyre, duke përfshirë politikën, procedurat, rregullat dhe strukturat. Në këtë aspekt, Banka e Shqipërisë gëzon kompetenca të qarta mbikëqyrëse.
- xii. Deri më sot, bankat dhe OTP-të nuk kanë bashkëpunuar për të krijuar produkte dhe mekanizma që mund të shfrytëzojnë infrastrukturën përkatëse, siç dëshmohet nga mungesa e mekanizmave që mundësojnë disbursimin e remitancave në llogaritë e transaksioneve/instrumentet elektronike. Bashkëpunimi më i fortë midis bankave të huaja dhe vendase, dhe OTP-ve ndërkombëtare- duke përfshirë zhvillimin e infrastrukturës dhe të pikave të aksesit- mund të sjellë mundësi të reja për zhvillim si edhe rritje të konkurrencës në ofrimin e shërbimeve.
- xiii. Mbikëqyrja e Bankës së Shqipërisë është përgjithësisht e rregulluar siç duhet. Megjithatë, ndërsa BSh-ja ka përgjegjësi të qartë për (rregullimin dhe) mbikëqyrjen e sistemeve dhe instrumenteve të pagesave, ofrimi i shërbimeve të pagesave në përgjithësi nuk përmban kompetenca të qarta. Baza ligjore e kompetencave të BSh-së (d.m.th., në nivel statutor) mund të qartësohet me qëllim mbulimin edhe të shërbimeve të pagesave (dhe remitancave). BSh-ja ka krijuar një Komitet Kombëtar të Sistemit të Pagesave për të nxitur bashkëpunimin për zhvillimin e sistemit të pagesave; megjithatë, ky komitet momentalisht nuk ka pjesëmarrjen e ofruesve jobanka të shërbimeve të pagesave.

---

<sup>8</sup> Përjashtime bëjnë operatorët e transferimit të parave, M-Pesa të cilat shpërndahen në llogaritë *mobile* (pritësit mund t'i marrin *cash* tek një agjent përkundrejt një komisioni) dhe në produkte të tjera të ofruara në kuadrin e bashkëpunimit të operatorëve të transferimit të parave (OTP-ve) me bankat (pavarësisht se këto shërbime janë në fazat fillestare).

<sup>9</sup> Ligji Nr.8269/1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar. Neni 3 i Ligjit, përcakton përgjegjësinë e BSh-së për funksionimin normal të sistemeve të pagesave në Shqipëri, duke e renditur në këtë mënyrë si një nga funksionet e saj. Në këtë nen përcaktohet se: "BSh, në përputhje me objektivin e saj kryesor dhe mbi bazën e tregut të brendshëm bankar, nxit dhe mbështet [...] sistemin e pagesave", dhe se: "Detyrat kryesore të BSh-së janë si më poshtë: [...] dh) të nxisë funksionimin normal të sistemit të pagesave". Neni 21 i këtij Ligji detajon më tej përgjegjësinë e mësipërme ligjore në fushën e zbatimit, në lidhje me organizimin dhe funksionimin e sistemeve të pagesave dhe shlyerjes si edhe instrumenteve të pagesave.

## RAPORT

### Hyrje

1. Bazuar në një kërkesë të vendeve të G8 (Sea Island, 2004) dhe të ministrave të financave të G7 (Boca Raton, 2004) për të zhvilluar standardet ndërkombëtare dhe udhëzimet për shërbimet e remitancave, Banka Botërore dhe Komiteti i Sistemeve të Pagesave dhe Shlyerjes (tani Komiteti i Pagesave dhe Infrastrukturave të Tregut) i Bankës për Rregullime Ndërkombëtare, disa banka qendrore, ashtu sikurse edhe palë të tjera të interesuara krijuan Parimet e Përgjithshme për Shërbimet e Remitancave Ndërkombëtare ("Parime të Përgjithshme").
2. Në samitin e L'Aquila, Itali, në korrik 2009, Kryetarët e Qeverive dhe Shteteve të G8 morën angazhim për arritjen e objektivit të uljes së kostos së shërbimeve të remitancave me pesë pikë përqindje për pesë vjet (d.m.th., objektivi pesë-për-pesë, matur nga Databaza Botërore e Çmimeve të Remitancave të Bankës Botërore, RPW).
3. Në Samitin e G20 në Seul, në nëntor 2010, liderët e G20 përsëritën rëndësinë e lehtësimit të lëvizjes së flukseve ndërkombëtare të remitancave. Plani i Veprimit Shumëvjeçar për Zhvillim i vitit 2010 përcakton: "Ne e pranojmë rëndësinë e lehtësimit të lëvizjes së flukseve ndërkombëtare të remitancave dhe përmirësimin e efikasitetit të tyre me qëllim rritjen e kontributit të tyre në uljen e varfërisë dhe rritjen e aftësisë për t'u përshtatur. Ne kërkojmë nga Banka Botërore, bankat rajonale për zhvillim dhe organizata të tjera të lidhura, përfshirë Grupin Global të Punës për Remitancat, që të punojnë me secilin anëtar dhe joanëtar të G20, me qëllim vazhdimin e implementimit të mëtejshëm të Parimeve të Përgjithshme për Shërbimet e Remitancave Ndërkombëtare dhe me iniciativat e tjera ndërkombëtare që kanë si qëllim reduktimin sasior të kostos mesatare globale të transferimit të remitancave". Më pas, në Kanë në vitin 2011, vendet e G20 miratuan objektivin pesë-për-pesë, dhe një listë të masave që vendet e G20 duhet të implementojnë për ta mbështetur këtë objektiv (*Remittance Toolkit*). Ndër nismat e tjera, *Remittance Toolkit* rekomandon që vendet të vlerësojnë nëse tregu i tyre kombëtar i remitancave zbaton rekomandimet e Parimeve të Përgjithshme.
4. Në Samiti e G20, në Brisbane në nëntor 2014, vendet e G20 u angazhuan sërish në objektivin 5% "për të ruajtur vrullin dhe për të përkthyer ambicien e G20 në rezultate praktike të zhvillimit". G20 gjithashtu pranoi se: "(i) reduktimi i kostove të remitancave dhe rritja e impaktit të tyre në zhvillim të mëtejshëm është një objektiv afatgjatë; (ii) kostot ndikohen nga kushtet e tregut në vendet dërguese dhe pritëse; dhe, (iii) një qëllim global luan një rol të dobishëm në nxitjen e veprimeve të mëtejshme".
5. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara kërkuan arritjen e objektivit të reduktimit në më pak se 3% të kostove të transaksionit të remitancave deri në 2030, dhe eliminimin e korridoreve të lëvizjes së remitancave që kanë kosto më të lartë se 5%.
6. Programi i Remitancave dhe i Pagesave i zbatuar nga Banka Botërore ka për qëllim rritjen e efikasitetit të pagesave me vlerë të vogël në vendet e përzgjedhura, me një fokus të veçantë në remitancat ndërkombëtare. Financimi i këtij programi në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore është mundësuar nga Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike të Zvicrës (SECO). Programi bazohet në standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira, të përcaktuara nga Banka Botërore dhe Komiteti i Pagesave dhe Infrastrukturave të Tregut, siç janë Parimet e Përgjithshme (GP) dhe Raporti për Aspekte të Pagesave në kuadër të Përfshirjes Financiare.



## Hapësira Informuese 1: Lista e Parimeve të Përgjithshme dhe rolet përkatëse

### **Parimi i Përgjithshëm 1: Transparenca dhe mbrojtja e konsumatorit**

Tregu i remitancave duhet të jetë transparent dhe të ofrojë mbrojtje të përshtatshme për konsumatorin.

### **Parimi i Përgjithshëm 2: Infrastruktura e sistemit të pagesave**

Duhet të inkurajohen zhvillime të infrastrukturës së sistemit të pagesave me potencial për të rritur eficiencën e shërbimeve të remitancave.

### **Parimi i Përgjithshëm 3: Mjedisi ligjor dhe rregullativ**

Shërbimet e remitancave duhet të mbështeten nga një kuadër ligjor dhe rregullativ i shëndoshë, i parashikueshëm, jodiskriminues dhe proporcional, në juridiksionet përkatëse.

### **Parimi i Përgjithshëm 4: Struktura e tregut dhe konkurrenca**

Tregu i remitancave duhet të mbështetet nga kushte konkurruese të tregut, duke përfshirë aksesin në infrastrukturën vendase në fushën e pagesave.

### **Parimi i Përgjithshëm 5: Qeverisja dhe menaxhimi i riskut**

Shërbimet e remitancave duhet të mbështeten nga praktika të përshtatshme qeverisjeje dhe menaxhimi të rrezikut.

### **Rolet e ofruesve të shërbimeve të remitancave dhe autoriteteve publike**

**A. Roli i ofruesve të shërbimeve të remitancave.** Ofruesit e shërbimeve të remitancave duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në zbatimin e Parimeve të Përgjithshme.

**B. Roli i autoriteteve publike.** Autoritetet publike duhet të vlerësojnë veprimet që duhet të ndërmerren për të realizuar objektivat e politikës publike nëpërmjet zbatimit të Parimeve të Përgjithshme.

7. Në këtë kontekst, anëtarë të Grupit të Bankës Botërore për Zhvillimin e Sistemeve të Pagesave, vizituan Shqipërinë në datat 13-16 shtator 2016, për të mbledhur informacion me qëllim përgatitjen e një pasqyre të tregut të remitancave bazuar në Parimet e Përgjithshme dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësime të mundshme. Grupi i Bankës Botërore drejtohej nga z. Carlo Corazza (Specialist i lartë i Pagesave dhe Remitancave), dhe përfshinte z. Nenad Bosiljčić (Konsulent, Koordinator Rajonal i Programit të Remitancave dhe Pagesave), znj. Elisabetta Cervone (Konsulente, Specialiste e Lartë Ligjore) dhe z. Jose Antonio Garcia (Konsulent, Këshilltar i Lartë i Sistemeve të Pagesave)<sup>10</sup>. Paralelisht, ky grup pune realizoi edhe vlerësimin e aspekteve të pagesave në kuadër të përfshirjes financiare, bazuar në Raportin e Komitetit të Pagesave dhe Infrastrukturave të Tregut të Bankës Botërore (CPMI-WB). Meqenëse këto vlerësime u realizuan në të njëjtën kohë dhe përfshinin të njëjtat çështje si kuadri ligjor, infrastruktura e pagesave etj., disa vëzhgime dhe rekomandime përkojnë me njëra-tjetrën, pavarësisht se të trajtuara në këndvështrime të ndryshme.

8. Grupi pati mundësinë të zhvillonte diskutime me disa aktorë të sektorit publik dhe privat në tregun e remitancave dhe konsideron se ka mbledhur mendime përfaqësuese nga pjesëmarrësit e ndryshëm mbi statusin aktual të tregut dhe mbi reformat në proces. Ndër institucionet me të cilat u organizuan takime ishte edhe Banka e Shqipërisë (BSH - departamente të ndryshme përgjegjëse për operimin dhe mbikëqyrjen e

<sup>10</sup> Ky mision u mbështet në distancë edhe nga znj. Maria Teresa Chimienti (Specialiste e Lartë e Sistemeve të Pagesave).

sistemit të pagesave, për çështjet ligjore, mbikëqyrjen e institucioneve financiare jobanka dhe statistikave), Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MoEDTE)<sup>11</sup>, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike (MIAP)<sup>12</sup> dhe Ministria e Brendshme (MPB). Ekipi u takua edhe me disa përfaqësues të sektorit privat, përfshirë: Shoqatën Shqiptare të Bankave (AAB), gjashtë ofrues të shërbimeve të pagesave të licencuara (Unioni Financiar Tiranë, AK Invest, MPay, MPesa dhe EasyPay, Posta shqiptare), 1 operator i sistemeve të pagesave (PayLink), dy bankat më të mëdha (Raiffeisen Bank dhe Banka Kombëtare Tregtare) dhe federatën e Unioneve të Kursim-Kreditit. Ekipi dëshiron të shprehë mirënjohjen e tij për autoritetet dhe për gjithë përfaqësuesit e institucioneve të vizituara, për bashkëpunimin e tyre gjatë misionit.

9. Ky raport paraqet rezultatet e analizës të bazuar në Parimet e Përgjithshme dhe përfshin vëzhgime dhe rekomandime si bazë për diskutime të mëtejshme mbi përmirësimin e tregut të shërbimeve të remitancave në Shqipëri. Raporti gjithashtu synon të identifikojë veprimet kryesore, të cilat sipas përvojës së ekipit në vendet e tjera, mund të çojnë në përmirësimin e sigurisë dhe efikasitetit të transaksioneve të dërgesave në dhe nga Shqipëria dhe të sjellin përfitime të tjera që lidhen me zbatimin e Parimeve të Përgjithshme.

10. Ky raport është i organizuar si më poshtë. Seksioni II jep një pasqyrë të tregut të remitancave në Shqipëri, duke përfshirë format e dërgesave nga emigrantët, dhe të dhënat në dispozicion për flukset dhe kostot e remitancave. Seksioni III përqendrohet në vlerësimin e Parimeve të Përgjithshme në Shqipëri dhe rolet e sektorit privat dhe autoriteteve publike. Prezantohet konteksti i çdo Parimi të Përgjithshëm, më pas paraqitet situata në Shqipëri, dhe në fund jepen rekomandimet përkatëse. Seksioni IV paraqet një plan veprimi të propozuar të nivelit të lartë dhe hapat potencialë që duhet të merren në konsideratë menjëherë nga autoritetet. Veprimet kryesore janë identifikuar në lidhje me Parimet e Përgjithshme, si standarde *de facto* për remitancat.

---

<sup>11</sup> Aktualisht Ministria e Financave dhe Ekonomisë

<sup>12</sup> Aktualisht Zëvendëskryeministri

## Vështrim i përgjithshëm

11. Republika e Shqipërisë (në vazhdim, Shqipëria) është një nga vendet e përfshira në fushën gjeografike të Programit të Remitancave dhe Pagesave në Ballkanin Perëndimor. Shqipëria është një vend i vogël (28,748 kilometra katrorë) në rajonin e Ballkanit Perëndimor, që ndodhet në Gadishullin Ballkanik, me një popullsi prej 2.8 milion banorë, pothuajse gjysma e të cilëve jetojnë në zonat rurale. Gjatësia bregdetare e Shqipërisë është 476 km, dhe shtrihet përgjatë detit Adriatik dhe atij Jon. Ultësira perëndimore ndodhet në anën e detit Adriatik.



Burimi: CIA Factbook.

12. Para krizës financiare globale, Shqipëria ishte një nga ekonomitë me rritje më të shpejtë në Evropë, me një rritje mesatare vjetore prej 6%, shoqëruar me një reduktim të shpejtë të varfërisë. Megjithatë, pas vitit 2008, rritja mesatare u përgjysmua dhe filluan të shfaqen zhbilancime makroekonomike në sektorin publik dhe në atë të jashtëm. Ritmi i zvogëluar i rritjes u pasqyrua në varfëri dhe papunësi: ndërmjet viteve 2002-2008, varfëria në vend u përgjysmua (në 12.4%), por në vitin 2012 u rrit përsëri në 14.3%. Papunësia u rrit nga 12.5% në 2008, në 17.6% në 2014, dhe që atëherë është ulur në nivelin 15.9% në 2016, ndërsa papunësia tek të rinjtë është 29.9%<sup>13</sup>.

13. Rritja ekonomike vlerësohet të jetë rreth 2.6% në vitin 2015 dhe 3.4% në vitin 2016. Tregu i punës në Shqipëri ka pësuar disa ndryshime dramatike gjatë dekadës së fundit, duke kontribuar në rritjen e produktivitetit. Punësimi formal jobujqësor në sektorin privat është më shumë se dyfishuar ndërmjet viteve 1999 dhe 2013, kryesisht i nxitur nga investimet e huaja. Emigrimi dhe urbanizimi sollën një ndryshim strukturor, duke iu larguar sektorit të bujqësisë dhe afruar më shumë sektorit të shërbimeve dhe industrisë, çka i lejoi ekonomisë të fillojë ofrimin e disa shërbimeve – nga sektori bankar e deri tek telekomunikacioni dhe turizmi<sup>14</sup>.

<sup>13</sup> Burimi: [www.tradingeconomics.com](http://www.tradingeconomics.com), INSTAT, 2016.

<sup>14</sup> *Ibid.*

14. Sektori financiar në Shqipëri është i përqendruar dhe dominuar nga bankat e huaja. Bankat disponojnë mbi 90% të aseteve financiare të të gjithë sektorit, ekuivalente me 90% të PBB-së. Në sektorin bankar në Shqipëri veprojnë 16 banka (Tabela 1).

**Tabela 1: Lista e bankave në Shqipëri**

<b>Banka</b>	<b>Pronësia</b>
<b>Banka Alpha Albania</b>	Alpha Bank, Greqi
<b>Banka NBG Albania</b>	Banka Kombëtare e Greqisë
<b>Banka Kombëtare Tregtare</b>	Çalık Holding, Turqi
<b>ProCredit Bank Shqipëri</b>	ProCredit Holding, Gjermani
<b>Credins Bank</b>	Individë Privatë, Shqipëri
<b>Raiffeisen Bank</b>	Raiffeisen Bank International AG, Austri
<b>Credit Bank of Albania</b>	Individë Privatë
<b>Banka Societe Generale Albania</b>	Societe Generale S.A., Francë
<b>American Bank of Investments</b>	SHBA
<b>Tirana Bank</b>	Piraeus Group, Greqi
<b>Fibank</b>	First Investment Bank, Bullgari
<b>Union Bank</b>	Unioni Financiar Tiranë sh.p.k, Shqipëri
<b>International Commercial Bank</b>	ICB Banking Group, Zvicër
<b>United Bank of Albania</b>	Islamic Development Bank, Arabi Saudite
<b>Intesa Sanpaolo Bank</b>	Intesa Sanpaolo, Itali
<b>Veneto Banka</b>	Gruppo Veneto Banca, Itali

*Burimi: Shoqata Shqiptare e Bankave.*

15. Aktiviteti bankar ka vazhduar të financohet kryesisht nga depozitat, të cilat përbëjnë rreth 82% të totalit të aktiveve. Raporti “kredi ndaj depozitave” është rreth 55%. Në shtator 2015, vëllimi i depozitave në lekë u rrit me 4% në terma vjetorë, pavarësisht një rënieje në normën mesatare të interesit. Baza e depozitave në monedhën vendase u rrit me 2.7%, ndërsa ajo në valutë u rrit me 5%. Mbështetja e sektorit bankar në burimet e huaja të financimit është shumë e kufizuar. Pozicioni neto i sektorit bankar ndaj jorezidentëve padyshim mbetet "i gjatë" dhe në zgjerim gjatë periudhës, ndonëse me një ritëm të ngadaltë. Huamarrja nga grupet e bankave mëmë u zvogëlua. Masat kundërciklike të marra nga Banka e Shqipërisë në maj 2013 kanë kontribuar në një rritje më të vogël të investimeve të sektorit bankar në aktivet e huaja. Rritja e tyre vjetore në shtator 2015 ra në 10%, nga 14% në 2014 dhe 24% në vitin 2013. Detyrimet ndaj jorezidentëve janë kryesisht në formën e linjave të kredisë. Pjesa e papërdorur e linjave të kredisë është ulur me 62% krahasuar me dhjetorin 2014 dhe me 55% në vitin 2015. Tabelat 2 dhe 3 paraqesin disa statistika bazë të sistemit të pagesave për Shqipërinë.

<sup>15</sup>Burimi: Programi i Reformës Ekonomike të Shqipërisë 2016-2018.

**Tabela 2: Statistika për kartat e pagesave dhe disponueshmërinë e ATM-ve dhe POS-eve (tremujori III 2016)**

<b>Kartat e pagesave/terminalat</b>	<b>Numri</b>
Karta me funksion <i>cash</i> -i	990,631
Karta me funksion pagese	950,571
<i>nga të cilat:</i>	
Karta me funksion debiti	865,296
Karta me funksion krediti	85,275
Karta me funksion para elektronike ( <i>E-money</i> )	40,060
<b>Numri total i kartave</b>	<b>990,631</b>
<i>nga të cilat:</i>	
Karta me funksione të kombinuara	<b>990,531</b>
<b>ATM</b>	<b>807</b>
<i>nga të cilat:</i>	
ATM me funksion tërheqje <i>cash</i> -i	798
ATM me funksion urdhër transferta	120
ATM me funksion depozitim <i>cash</i> -i	79
<b>Terminale POS (<i>Point of Sale</i>)</b>	<b>7,144</b>
<i>nga të cilat:</i>	
Terminale POS me funksion tërheqje <i>cash</i> -i	99
Terminale EFTPOS	7,045
Terminale virtuale për përdorimin e kartave	29
Terminale për përdorimin e parasë elektronike	685

*Burimi: Banka e Shqipërisë.*

**Tabela 3: Të dhëna për transaksionet me instrumente të pagesave (tremujori III 2016)**

<b>Produkti/zëri</b>	<b>Vëllimi</b>	<b>Vlera (në milionë lekë)</b>
Transaksione me karta të pagesave (debiti, krediti)	2,260,403	17,668
Urdhër transferta elektronike	1,274,962	242,088.15
Urdhër transferta në formë letër	4,421,975	2,910,748.17
Debitimi direkt	545,053	29,488.71
Karta të parasë elektronike (në formë letër)	171,337	643.15
Çeqe	24,827	61,640.26

*Burimi: Banka e Shqipërisë.*

16. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, 1.3 milionë emigrantë shqiptarë jetojnë jashtë vendit, që përbën 40% të popullsisë aktuale që jeton brenda kufijve shqiptarë<sup>16</sup>. Ata janë të vendosur kryesisht në Itali, Greqi, Gjermani dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Disa komunitete të vogla gjenden edhe në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Austri, Kanada, Francë, Rumani, Belgjikë, Rusi, rajonin Skandinav, Zvicër, Ukrainë dhe Mbretërinë e Bashkuar (Tabela 4).

<sup>16</sup> Banka Botërore, 2015.

**Tabela 4: Vendet me diasporën më të madhe shqiptare**

Vendet	Numri
<b>Greqi</b>	580,000
<b>Itali</b>	450,000
<b>SHBA</b>	85,000
<b>Gjermani</b>	40,000
<b>Republika (ish Jugosllave) e Maqedonisë</b>	25,000

*Burimi: Census në Shqipëri, 2011.*

17. Shqipëria është një vend pritës i remitancave. Flukset e remitancave në Shqipëri u vlerësuan të ishin në masën 8.5% të PBB-së së vendit për vitin 2014, që korrespondon me rreth 1.1 miliardë dollarë<sup>17</sup>. Vlerësohet se 37% e flukseve të remitancave kanalizohen nëpërmjet shërbimeve dhe sistemeve të parregulluara, ndërsa 57% kalojnë përmes Operatorëve të Transferimit të Parave (OTP) dhe 4% nëpërmjet bankave<sup>18</sup> (shih Hapësirën Informuese 2). Sipas të dhënave të Bankës Botërore për vitin 2015, remitancat jashtë vendit arritën në 151 milionë dollarë amerikanë ose 10% të remitancave brenda vendit.

#### **Hapësira Informuese 2: Vrojtimi Bazë i Grupit të Punës së Bankës Botërore mbi sjelljen financiare të përfituesve të remitancave në Shqipëri**

Në vitin 2016, Grupi i Bankës Botërore në kuadër të Programit të Remitancave dhe Pagesave, financuar nga Sekretariati Shtetëror Zvicëran për Çështjet Ekonomike (SECO), kreu Vrojtimit Bazë mbi sjelljet financiare të përfituesve të remitancave në gjashtë vende të Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore (ECA), përkatësisht: Shqipëri, Kosovë, Serbi, Bosnje dhe Hercegovinë, Taxhikistan dhe Republika Kirgize. Objektivi kryesor i këtij vrojtimi ishte të kuptohej sjellja e pritësve të remitancave në vendet e përzgjedhura dhe niveli i plotësimit të kërkesave të tyre nga produktet dhe shërbimet ekzistuese të remitancave.

Sipas Studimit Bazë, 86% e familjeve të intervistuar<sup>19</sup> në Shqipëri kanë përfituar dërgesa nga një person, i moshës 30-44 vjeç, i cili është në emigrim të përhershëm, dy ose tre herë në vit, për më shumë se 10 vite. Shuma mesatare e marrë gjatë një viti është ekuivalente me 2,350 USD ose 499 USD për transaksion, që është shuma e dytë më e lartë në rajon pas Kosovës. Shumica e flukseve të remitancave vijnë nga Greqia dhe Italia (më shumë se 60%).

Remitancat përfaqësojnë një të tretën e buxhetit vjetor të një familjeje në Shqipëri. Më shumë se 30% e familjeve të intervistuar i përfitojnë rregullisht remitancat, ndërsa 40% sigurojnë mbështetje financiare nga të afërmit e tyre jashtë vendit në raste të veçanta. Remitancat përdoren kryesisht për mallrat e konsumit të shpejtë (FMCG) dhe për produktet e shëndetit dhe higjienës (të zgjedhur nga 67% e familjeve të intervistuar), për shpenzimet shëndetësore (52%) dhe për qëllime arsimimi (32%).

<sup>17</sup> Llogaritjet e stafit të BB-së bazohen në të dhënat e marra nga databaza e FMN-së për Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe nga të dhëna të publikuara nga bankat qendrore, agjencitë kombëtare të statistikave dhe tryezat e punës së Grupit të Bankës Botërore, Tetor 2014.

<sup>18</sup> Të dhëna të mbledhura nga Vrojtimi Bazë i Grupit të Punës së Bankës Botërore mbi sjelljen financiare të përfituesve të remitancave në Shqipëri, 2016.

<sup>19</sup> Sipas modelit, madhësia e kampionit ishte të paktën 800 familje përfituese të remitancave për çdo vend.

Shqipëria ka përdorimin më të ulët të bankave ose institucioneve të tjera financiare për transfertat e dërgesave në rajon, kryesisht për shkak të kompleksitetit të procesit (procedurat e bankave perceptohen si komplekse dhe konfuze) dhe kostove të larta të transfertave. Më shumë se 50% e shqiptarëve nuk disponojnë një llogari bankare, ndërsa vetëm 35% përdorin një kartë pagese.

18. Sipas të dhënave të raportuara pranë Bankës së Shqipërisë, vlera e përgjithshme e transfertave person-me-person të kryera përmes llogarive bankare dhe Operatorëve të Transferimit të Parave (OTP) në tremujorin e dytë të vitit 2016 ishte 153 milionë euro (162.6 milionë dollarë) (shih tabelën 5). Western Union është subjekti më dominues nga Operatorët e Transferimit të Parave, me 62.1% të transfertave, që arrijnë në 94 milionë euro (99.9 milionë dollarë), ndërsa MoneyGram merr 37.9% me 58 milionë euro (61.6 milionë dollarë). Korridoret kryesore janë Italia, Britania e Madhe, Gjermania, Greqia dhe SHBA. Është e rëndësishme të theksohet se disa Operatorë të Transferimit të Parave veprojnë në vend përmes partneriteteve me disa banka lokale dhe flukset e tyre mund të mos raportohen plotësisht nga bankat.

**Tabela 5: Transfertat e realizuara nëpërmjet OTP-ve – Korridoret kryesore**

Vendi dërgues	Milionë EURO/ USD	%
Itali	44.3 / 47.1	29
Mbretëri e Bashkuar	36.7 / 39.0	24
Gjermani	23 / 24.4	15
Greqi	13.7 / 14.6	9
SHBA	1.1 / 1.2	7

Burimi: Banka e Shqipërisë, 2016.

19. Kostoja e dërgimit të remitançave në Shqipëri në tremujorin e tretë të vitit 2016 ishte 9.39% e shumës së dërguar, që është mbi nivelin global (7.40) dhe mesataren rajonale (7.25). Kosto më e lartë e dërgesave është në korridorin me Zvicrën, 24.90%, ndërsa më e lirë është ajo me Italinë, 5.36%. Kostoja e dërgimit të parave nga Gjermania dhe Britania e Madhe në Shqipëri është midis 9.50 dhe 10%<sup>20</sup>.


**Tabela 6: Kosto mesatare e dërgimit të parave në Shqipëri**

	Zvicër		Gjermani		Mbretëri e Bashkuar		Itali	
	CHF 160		EUR 140		GBP 120		EUR 140	
Operatori i Transferimit të Parave	Kosto në CHF	Kosto në përqindje	Kosto në EUR	Kosto në përqindje	Kosto në GBP	Kosto në përqindje	Kosto në EUR	Kosto në përqindje
Western Union	39.85	24.90	20.43	14.60	15.97	13.31	15.53	11.09
MoneyGram	23.68	14.80	13.07	9.33	10.63	8.85	13.20	9.43
Ria	15.28	9.55	10.00	7.14	9.77	8.14	7.50	5.36

Burimi: Çmimet (Kostot) Botërore të Remitançave, tremujori 4 2016

<sup>20</sup> Remittance Prices Worldwide – Çmimet (Kostot) Botërore të Remitançave, tremujori IV 2016.

**Figura 1: Kosto totale e dërgimit të 200 usd në Shqipëri**



Burimi: Çmimet (Kostot) Botërore të Remitancave



## Vlerësimi i Parimeve të Përgjithshme sipas Komitetit të Pagesave dhe Infrastrukturave të Tregut - Banka Botërore

### Parimi i Përgjithshëm 1: Transparenca dhe mbrojtja e konsumatorit

#### **Parimi i Përgjithshëm 1: Tregu i remitançave duhet të jetë transparent dhe të ofrojë mbrojtje të përshtatshme për konsumatorin.**

##### *Konteksti*

20. Transparenca në shërbime, e kombinuar me një mbrojtje të përshtatshme të konsumatorit, ndihmon në nxitjen e një tregu konkurrues dhe të sigurt për remitançat. Transparenca e çmimeve dhe karakteristikat e shërbimit janë vendimtare për t'i mundësuar konsumatorit të bëjë zgjedhje të mirinformuara ndërmjet shërbimeve të ndryshme, si edhe për të krijuar një treg konkurrues. Prandaj, Ofruesit e Shërbimeve të Remitançave duhet të inkurajohen ta ofrojnë një informacion të tillë në mënyra të aksesueshme dhe të kuptueshme. Për aq sa është e mundur, ky informacion duhet të përfshijë çmimin total (p.sh. tarifën në të dy anët, kurset e këmbimit valutor duke përfshirë kufijtë e aplikuar mbi to dhe kostot e tjera për përdoruesit), kohën e nevojshme që fondet të kalojnë nga dërguesi tek pritësi, dhe vendndodhjet specifike të pikave të aksesit të Ofruesve të Shërbimeve të Remitançave në të dy vendet, dërguese dhe pritëse. Gjithashtu duhet të jetë e qartë për dërguesin nëse çmimi ose aspekte të tjera të shërbimit ndryshojnë, p.sh. në varësi se si paguhet pritësi (p.sh. në *cash* apo nëpërmjet kreditimit të një llogarie) ose aftësinë e dërguesit për të dhënë informacion në lidhje me pritësin (p.sh. numri i llogarisë dhe identifikuesin e bankës.)

21. Mbrojtja e duhur për konsumatorin është gjithashtu e rëndësishme. Dërguesit duhet të kenë të drejta si klientë të shërbimeve të remitançave, përfshirë procedurat administrative për zgjidhjen e gabimeve. Megjithëse shumë vende kanë mekanizma për të zgjidhur mosmarrëveshjet e konsumatorëve brenda vendit, natyra ndërkufitare e remitançave dhe barrierat kulturore e gjuhësore mund t'i vështirësojnë këto procedura. , Autoritetet mund të dëshirojnë të vlerësojnë përshtatshmërinë e procedurave ekzistuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe dispozitave të tjera për mbrojtjen e konsumatorit në kontekstin e shërbimeve të remitançave, ku e gjykojnë të arsyeshme.

##### *Statusi në Shqipëri*

22. Duke qenë se Shqipëria është një vend pritës i remitançave, zgjedhja e kanaleve të dërgesave varet kryesisht nga dërguesit, të cilët ndodhen jashtë vendit, megjithëse zgjedhja e këtyre të fundit ndikohet nga eksperiencia e pritësit. Praktika e zakonshme e OTP-ve globale nuk është që ato të aplikojnë tarifa në anën e pritësit. Ky duket të jetë rasti edhe në Shqipëri. Kur dërguesi ndodhet në një vend të Bashkimit Evropian (BE), publikimi i tarifave dhe informacionit për klientët rregullohet nga Direktiva e Komisionit Evropian mbi Shërbimet e Pagesave (PSD1), e cila e përcakton opsionin e publikimit në varësi të shtetit anëtar. Direktiva e Rishikuar e Komisionit Evropian mbi Shërbimet e Pagesave (PSD2), që hyn në fuqi në vitin 2018, do të ofrojë kërkesa shtesë për dhënien e informacioneve, si dhe do të përfshijë transfertat drejt vendeve joanëtare të BE-së ("transaksionet me një këmbë").

23. Ligji nr. 9902 i vitit 2008 synon mbrojtjen e interesave të konsumatorëve shqiptarë. Megjithatë, ky ligj nuk mbulon ofrimin e shërbimeve financiare, prandaj nuk zbatohet as për shërbimet e pagesave/remitançave. Në këtë fushë të veçantë, transparenca dhe mbrojtja e konsumatorit trajtohen nëpërmjet legjislacionit sekondar. Rregullorja nr. 59 e vitit 2008 "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare" (në vazhdim "Rregullorja e Transparencës") zbatohet për marrëdhëniet e bankave dhe institucioneve financiare jobanka (IFJB) me klientët e tyre. Kjo rregullore përcakton kërkesat për dhënien e

informacionit ndaj klientit mbi produktet dhe shërbimet bankare e financiare. Rregullorja zbatohet për bankat dhe institucionet financiare jobanka dhe për rrjedhojë edhe për OTP-të (Operatorët e Transferimit të Parave)<sup>21</sup>.

24. Rregullorja e transparencës gjithashtu kërkon që ofruesit e shërbimeve financiare t'u japin klientëve gjithë informacionin mbi procedurat e duhura për të administruar dhe zgjidhur ankesat e tyre. Procedurat e brendshme për zgjidhjen e ankesave duhet të regjistrohen në një dokument të brendshëm, dhe klienti duhet të marrë një përgjigje me shkrim. Të gjitha ankesat duhet të regjistrohen, duke përcaktuar origjinën e problemit, masat e marra dhe informacione të tjera të rëndësishme. Rregullorja nr. 11 e vitit 2008 "Për instrumentet e pagesave elektronike" gjithashtu përfshin dispozita mbi standardet e transparencës ndaj klientëve në lidhje me kushtet, rregullat dhe procedurat për pagesat elektronike.

25. Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorit (KMK), i krijuar në vitin 2009, është organi përgjegjës për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit. KMK është një organ vendimmarrës, qëllimi i të cilit është të mbikëqyrë trajtimin e ankesave të klientëve dhe të lehtësojë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Megjithatë, kompetencat e KMK-së janë mjaft të kufizuara në fushën e produkteve dhe shërbimeve financiare dhe mosmarrëveshjet në këtë fushë shqyrtohen me ndihmën e BSH-së.

26. OTP-të në përgjithësi i afishojnë tarifat e përgjithshme dhe kurset e këmbimit në vendin e ushtrimit të aktivitetit të tyre. Ekipi mund të konfirmojë që klientët e OTP-ve në përgjithësi janë të informuar nga Ofruesit e Shërbimeve të Remitancave për komisionin, kursin e këmbimit të aplikuar dhe kushtet e shërbimit para se të kryhet një transaksion. Informacioni zakonisht ofrohet verbalisht, por edhe në njoftime ose fletëpalosje dhe paraqitet në mandatet e pagesave.

#### *Rekomandime*

27. **Autoritetet duhet të hartojnë legjislacionin e duhur në fushën e transparencës dhe mbrojtjes së konsumatorit për shërbimet financiare, duke përfshirë pagesat dhe remitancat.** Për momentin, kuadri ligjor përkatës përbëhet vetëm nga rregullore dhe nuk ka një autoritet të caktuar për zbatimin e rregullave në fushën e mbrojtjes dhe transparencës së konsumatorit në lidhje me shërbimet financiare.

28. **BSH dhe autoritete të tjera duhet të marrin në konsideratë vendosjen e standardeve të përbashkëta për publikimin e informacionit në fushën e remitancave.** Kostoja e transferimit të remitancave zakonisht përbëhet nga elemente të ndryshme, duke përfshirë komisionin e paguar nga dërguesi, kursin e këmbimit të aplikuar nga OTP-të, komisionin që duhet të paguhet nga pritësi dhe komponentë të tjerë si taksat etj. Si rrjedhim, transparenca e kostove të remitancave përgjithësisht nuk është e drejtpërdrejtë dhe kërkon një përpjekje nga OTP-të për të vënë në dispozicion gjithë informacionin e duhur, si dhe ndërgjegjësimin dhe edukimin e dërguesit dhe pritësit se si komponentët e ndryshëm ndikojnë në koston totale të transaksionit. Si shembull, në Shtetet e Bashkuara, Byroja e Mbrojtjes Financiare të Konsumatorit miratoi kërkesa specifike për publikimin e informacionit dhe madje dha një model standard për mandatet. Kjo rregullore mund të konsiderohet si një praktikë e mirë dhe ndoshta mund të konsiderohet si një pikë referimi nga autoritetet shqiptare<sup>22</sup>.

29. **Autoritetet dhe sektori privat duhet të bëjnë përpjekje për ndërgjegjësimin dhe edukimin financiar.** Edukimi rreth remitancave (p.sh. karakteristikat e shërbimit, tarifat, kursi i këmbimit) dhe zgjedhja e kanaleve duhet të përfshihen në përpjekje të tilla (shih Hapësirën Informuese 3). Duhet të theksohen rreziqet e transferimit/marrjes së parave përmes kanaleve të parregulluara, dhe nga ana tjetër të theksohen përfitimet nga përdorimi i atyre të rregulluara/zyrtare.

<sup>21</sup> OTP-të në Shqipëri janë të licencuara si institucione financiare jobanka. Më shumë detaje lidhur me kuadrin ligjor jepen në paragrafët e mëposhtëm.

<sup>22</sup> Për më shumë informacion referohu: <http://www.consumerfinance.gov/remittances-transfer-rule-amendment-to-regulation-e/>

### Hapësira Informuese 3: Projekti *Greenback 2.0* – *Crash Course*

Projekti *Greenback* është një iniciativë e Grupit të Bankës Botërore që angazhon komunitete të emigrantëve në qytete të përzgjedhura, të cilëve u ofron edukim financiar dhe rritje të ndërgjegjësimit. Në Projektin *Greenback 2.0*, janë përzgjedhur qytetet kampion të remitancave. Objektivi i përgjithshëm është rritja e efikasitetit në tregun e remitancave nëpërmjet një qasjeje inovative: nxitja e ndryshimit nisur nga nevojat reale të përfituesve përfundimtarë të transfertave ndërkombëtare të parave - pra, emigrantët dhe familjet e tyre në vendin e origjinës. Bashkëpunimi midis emigrantëve, ofruesve të shërbimeve të remitancave dhe autoriteteve publike është çelësi për arritjen e objektivit të këtij projekti.

#### **Objektivat e *Crash Course***

Ndër aktivitetet e zbatuara në kuadër të *Greenback 2.0*, "*Crash Course*" ka për qëllim t'u ofrojë përfituesve informacion dhe të dhëna, të cilat do t'i ndihmojnë të bëjnë zgjedhje të informuara se si të dërgojnë para në shtëpi (për palën dërguese) dhe të kenë më shumë akses në shërbimet financiare. Informacioni i siguruar nga *Crash Course* është objektiv dhe nuk promovon, në asnjë mënyrë, një produkt specifik, operator të transferimit të parave apo llojin e operatorit.

#### **Pse ofrohet *Crash Course*?**

*Crash Course* siguron informacion që stimulon interesin dhe motivon për të rritur njohuritë rreth shërbimeve financiare. Qëllimi është të ofrojë disa informacione bazë dhe të stimulojë përfituesin për të zbuluar më shumë përmes kanaleve të ndryshme që mund të jenë në dispozicion.

#### **Kujt i adresohet *Crash Course*?**

*Crash Course* është dizenuar për emigrantët dhe familjarët e tyre dhe realizohet në kohën kur ata presin të kryejnë shërbimet, p.sh. tek posta ose zyrat e institucioneve shtetërore.

#### **Si funksionon?**

Në vende të caktuara (zyra postare, banka, zyra qeveritare) ku emigrantët ose familjet e tyre zakonisht duhet të presin në radhë, trajnerët e projektit u ofrojnë personave potencialisht të interesuar, sa më shpejt të jetë e mundur (10-15 minuta), informacione financiare bazë rreth operatorëve të transferimit të parave, karakteristikave të tyre dhe elementeve që duhet të marrin parasysh gjatë zgjedhjes së shërbimit që i përshtatet më mirë nevojave të tyre, si dhe aksesit në llogaritë e transaksioneve dhe shërbimeve të tjera financiare.

*Crash Course* administrohet duke përdorur një tabletë, është interaktive dhe e angazhon emigrantin në një lojë të shkurtër në formë *quiz*-i. Nga informacioni i mbledhur gjenerohet një profil. Profili përcakton se sa i informuar dhe i përgatitur është përfituesi, rreth shërbimeve dhe opsioneve në dispozicion (i informuar, gjysmë i informuar, i nxituar/i pavendosur, i painformuar, i papërgatitur). Bazuar në profilin e përfituar, pjesëmarrësit në *Crash Course* përfitojnë një dhuratë (një laps, një mbajtëse çelësash, një stilolaps për më pak të informuarit dhe një bluzë ose një çantë për më të informuarit). Pasi profili i paraqitet përfituesit, trajneri fillon *Crash Course*-in, duke e përshtatur atë kohë pas kohe në bazë të dobësive të vëna re gjatë *quiz*-it (vëmendje e pamjaftueshme për kursin e këmbimit ose tarifat e llogarive, kanali i zgjedhur ekskluzivisht në bazë të komoditetit ose shpejtësisë, etj.).

#### **Si të zbatohet *Crash Course*?**

Identifikimi i vendeve të mundshme, të tilla si zyrat postare, bankat, zyrat qeveritare, zyrat/shoqatat e tjera. Krijohet kontakt me këto vende dhe futen në Projektin *Greenback 2.0* dhe në *Crash Course*. Nëse

një vend pranon të lejojë *Crash Course*-in të zhvillohet në ambientet e tyre, atëherë hapi tjetër është dakordësimi lidhur me kohën dhe aspekte të tjera.

Për zbatimin e *Crash Course*, trajnerët shkojnë në vendin e përzgjedhur në datën e dakorduar, të pajisur me tableta, dhurata, dhe broshura/fletëpalosje rreth Projektit. Që në kontaktin e parë me personat, duhet të sqarohet se qëllimi i *Crash Course* nuk është të shesë apo të promovojë ndonjë produkt komercial.

Numri i personave që kanë marrë pjesë në *Crash Course* regjistrohet. Informacioni bazë që duhet të merret, mund të përfshijë: numrin total të personave që kanë përfunduar *Crash Course*, vendin e origjinës dhe profilin e tyre që rezultoi nga anketa. Mund të kërkohet një adresë kontakti e-mail nga personat që dëshirojnë të informohen për aktivitete të tjera të Projektit.

### **Mësimet e nxjerra**

*Crash Course* siguron informacione dhe burime shtesë për emigrantët në mënyrë që ata të mund t'u kërkojnë ofruesve të shërbimeve informacione të mëtejshme rreth produkteve financiare. Gjatë prezantimit të shërbimeve të ndryshme të remitancave tek një strukturë/organizatë/kompani, trajnuesi duhet të identifikojë produktet dhe shërbimet në dispozicion që i përshtaten më mirë nevojave të përfituesit.

### **Për çfarë duhet të jemi të vetëdijshëm**

*Crash Course* kryhet në respekt të plotë të përfituesve potencialë duke marrë parasysh kohën, procedurat dhe kufizimet ligjore të vendit.

## Parimi i Përgjithshëm 2: Infrastruktura e sistemeve të pagesave

### **Parimi i Përgjithshëm 2: Duhet të inkurajohen zhvillime të infrastrukturës së sistemit të pagesave që kanë potencial për të rritur eficiencën e shërbimeve të remitancave.**

#### *Konteksti*

30. Shërbimet e remitancave, me përjashtim të atyre që bazohen tërësisht në *cash*, varen në një farë mase nga infrastruktura vendase për shlyerjen e pagesave (dhe ndonjëherë edhe për transferimin e informacionit). Ofruesit e shërbimeve të remitancave shpesh mund ta shfrytëzojnë më mirë një infrastrukturë pagesash të zhvilluar përmes standardizimit më të madh të instrumenteve të pagesave, mënyrës më automatike të përpunimit të tyre dhe ndërveprimit më të lartë të rrjeteve të lidhura.

31. Duhet të inkurajohen përmirësimet në infrastrukturën e pagesave ndërkufitare, të cilat mundësojnë edhe rritjen e eficiencës së shërbimeve të remitancave. Gjithashtu, mund të jetë e mundur të realizohet një lidhje direkte midis sistemeve të pagesave me vlerë të vogël të vendeve dërguese e pritëse, veçanërisht kur sistemet e pagesave në të dy vendet janë të mirëzhvilluara dhe kanë mbulim të gjerë gjeografik dhe ku vëllimi i remitancave midis vendeve është i lartë.

32. Ndonjëherë vetë tregu mund të ndërmarrë përmirësime të tilla të infrastrukturave të pagesave. Sidoqoftë, duke pasur parasysh, së pari natyrën e ndryshme të institucioneve të përfshira dhe rrjedhimisht edhe mundësinë për konflikt interesi dhe, së dyti, pasigurinë lidhur me shkallën e flukseve të ardhshme dhe rrjedhimisht, nëse investimi është i justifikuar, në shumë raste autoritetet dhe në veçanti bankat qendrore, mund të dëshirojnë të ndihmojnë në zhvillimin e këtyre mundësive. Në përgjithësi, nismat ndërkufitare apo ndërsektoriale kërkojnë një nivel të lartë bashkëpunimi dypalësh (ose edhe shumëpalësh) në çështjet teknike, rregullatore dhe mbikëqyrëse dhe, rrjedhimisht, kërkojnë përfshirjen e gjerë të bankave qendrore, rregullatorëve, operatorëve të sistemeve të pagesave, shoqatave të bankave dhe bankierëve, shoqatave dhe përfaqësuesve të tjerë të industrisë nga të dy juridiksionet. Në disa raste, vetë bankat qendrore kanë zhvilluar lidhje dypalëshe ndërkufitare midis sistemeve të pagesave që ato operojnë.

#### *Statusi në Shqipëri*

33. Banka e Shqipërisë është aktori kryesor në Sistemin Kombëtar të Pagesave, nëpërmjet operimit, rregullimit dhe mbikëqyrjes së infrastrukturës përkatëse, pjesëmarrësve dhe shërbimeve në fushën e pagesave me vlerë të madhe dhe të vogël. Deri tani, Banka e Shqipërisë ka në pronësi dhe operon 2 sisteme pagesash<sup>23</sup>:

- a. Sistemi shqiptar i pagesave ndërbankare me vlerë të madhe (AIPS). Ky është një sistem i shlyerjes bruto në kohë reale i pagesave me vlerë të madhe ndërmjet pjesëmarrësve ose për llogari të klientëve të tyre, si edhe ndërmjet pjesëmarrësve dhe Bankës së Shqipërisë. Në vitin 2016, në sistemin AIPS janë përpunuar mesatarisht 500 urdhërpagesa në ditë, dhe vlera mesatare e secilës urdhërpagesë është afërsisht 57 milionë lekë (467,000 dollarë)<sup>24</sup>. Të 17 pjesëmarrësit përfshijnë Bankën e Shqipërisë dhe të gjitha bankat e licencuara. Institucionet financiare jobanka nuk mund të jenë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në AIPS, sepse Ligji për Bankën e Shqipërisë përcakton se vetëm bankat mund të hapin llogari dhe të mbajnë depozita në BSH. Ky kufizim zbatohet edhe për operatorët e sistemeve të tjera të pagesave dhe të shtëpive të klerimit<sup>25</sup>, në të cilat duhet të bëhet shlyerja e pozicioneve që rezultojnë nga procesi i klerimit përmes një agjenti të shlyerjes (d.m.th një nga bankat tregtare ose BSH).

<sup>23</sup> BSH, ka në pronësi dhe operon edhe sistemin e shlyerjes së titujve, AFISaR.

<sup>24</sup> Është e rëndësishme të sqarohet se tipet e ndryshme të urdhërpagesave që procesohen në sistemin AIPS mund të variojnë në mënyrë të konsiderueshme, pasi ato mund të lidhen ose me operacione ndërbankare ose me pagesa të klientëve.

<sup>25</sup> Deri në shtator të vitit 2016, vetëm *PayLink* është licencuar nga BSH si operator i sistemeve të pagesave. Shiko më poshtë.

b. Sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël (AECH - Albanian Electronic Clearing House). Kjo infrastrukturë përfaqëson një shtëpi automatike klerimi, e aftë për të procesuar instrumentet e urdhërtransfertave dhe debitimeve direkte. Megjithatë, aktualisht, janë procesuar vetëm të parat (urdhërtransfertat). Përdorimi i AECH-së është rritur mjaft shpejt midis viteve 2009-2011 dhe që atëherë rritja mesatare vjetore ka qenë e qëndrueshme në një nivel prej 5%. Në vitin 2016, në sistemin AECH janë procesuar rreth 2,000 pagesa në ditë, me një vlerë mesatare prej 178,000 lekësh ose 1,460 USD për pagesë<sup>26</sup>. Pjesëmarrja në AECH mund të jetë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë. Aktualisht vetëm bankat tregtare dhe BSH-ja lejohen të jenë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë, ndërsa i vetmi pjesëmarrës i tërthortë është Ministria e Financave. Rregullorja përkatëse në këtë fushë parashikon që pjesëmarrja indirekte duhet të miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, por nuk përmenden kriteret që duhen zbatuar nga Këshilli Mbikëqyrës për të marrë këtë vendim. Pozicionet neto debitore të pjesëmarrësve të sistemit AECH nuk janë të kolateralizuara *ex-ante* (para ndodhjes së transaksionit), dhe as nuk ka kufizime për madhësinë e tyre. Në rast të fondeve të pamjaftueshme, pjesëmarrësit në AECH mund të sigurojnë likuiditet duke marrë një kredi brenda ditës, operacion që pasqyrohet në AIPS, por kjo nënkupton që pjesëmarrësi është një bankë. Në mënyrë alternative, pjesëmarrësit mund të marrin kredi ditore nga BSH-ja, ku si kolateral shërbejnë titujt e qeverisë.

34. Kur krahasojmë shpërndarjen e pikave të aksesit në Shqipëri me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Shqipëria renditet në vendin e pestë dhe në vendin e fundit, respektivisht për numrin e degëve të bankave dhe ATM-ve për 100,000 banorë, me 22.2 degë dhe 35.3 ATM<sup>27</sup> (shiko Tabelat 7 dhe 8). Infrastruktura e pikave të shitjes - POS është gjithashtu e kufizuar dhe përsëri pozicionohet dobët në krahasim me vendet e tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor (shih Tabelën 9).

**Tabela 7: Numri i degëve të bankave për 100,000 banorë (të rritur)-Vendet e Ballkanit Perëndimor (2015)**

Vendi	Numri i degëve
Mal i Zi	43
Serbi	29.6
Bosnje dhe Hercegovinë	27.9
Maqedoni	24.7
<b>Shqipëri</b>	<b>21.9</b>
Kosovë	20.6

Burimi: Vrojtimi për Akses Financiar, Fondi Monetar Ndërkombëtar, 2015.

**Tabela 8: Numri i ATM-ve për 100,000 banorë (të rritur)-Vendet e Ballkanit Perëndimor (2015)**

Vendi	Numri i ATM-ve
Mal i Zi	76.2
Maqedoni	60.8
Bosnje dhe Hercegovinë	45.8
Serbi	45.5
Kosovë	40.4
<b>Shqipëri</b>	<b>35.1</b>

<sup>26</sup> Bazuar në parametrat ndërkombëtarë, kjo është një vlerë relativisht e madhe për një sistem të pagesave me vlerë të vogël.

<sup>27</sup> Vrojtimi për Akses Financiar, Fondi Monetar Ndërkombëtar, 2014.

**Tabela 9: Numri i terminaleve POS për 100,000 banorë (të rritur)-Vendet e Ballkanit Perëndimor (2015)**

Vendi	Numri i terminaleve POS
Mal i Zi	2,250.5
Maqedoni	1,948.6
Serbi	921.8
Kosovë	540.0
Bosnje dhe Hercegovinë	501.6
<b>Shqipëri</b>	<b>284.2</b>

Burimi: Vrojtimi për Akses Financiar, Fondi Monetar Ndërkombëtar, 2015



35. Në Shqipëri nuk ka një platformë për procesimin e kartave të pagesave (ose një *switch* kombëtar të kartave). Megjithatë, në shumicën e rasteve, rrjetet lokale të POS-eve dhe ATM-ve janë të lidhura me rrjetet ndërkombëtare të përpunimit të kartave Visa dhe MasterCard, duke bërë të mundur tërheqjen e parave/pagesave me një kartë Visa ose MasterCard, të lëshuar nga një bankë lokale, në shumicën e ATM-ve/terminaleve POS.

36. BSH ka licencuar gjithashtu subjektin PayLink si operator të pagesave me kartë dhe prodhues të kartave të pagesave. Aktualisht, PayLink shërben si operator i pagesave me kartë vetëm për Union Bank, i cili zotëron 80% të kompanisë PayLink. Kompania ka zhvilluar një *switch* të kartave të pagesave, të certifikuar plotësisht nga Visa dhe Mastercard dhe është gati për fillimin e aktivitetit. Megjithatë, bankat e tjera duket se nuk janë të gatshme të marrin pjesë në këtë skemë. Një arsye e mundshme është se aksioneri kryesor i PayLink është një bankë e cila është gjithashtu një emetues kartash, dhe si i tillë perceptohet si konkurrent i drejtpërdrejtë.

37. Në përgjithësi, *cash*-i është mjeti më dominues për kryerjen e pagesave me vlerë të vogël. Të dhënat nga ana e kërkesës tregojnë se mbi 96% të pagesave të iniciuara nga konsumatorët janë në *cash*<sup>28</sup>. Megjithatë, përdorimi i pagesave elektronike në tregun e pagesave me vlerë të vogël po rritet, me tendencë të ndryshme në varësi të instrumentit të përdorur. Figura 2 më poshtë tregon tendencë në përdorimin e instrumenteve të pagesave, të shprehura në vëllim dhe në vlerë të transaksioneve nga viti 2008 deri në vitin 2015. Rritja më e madhe ishte në përdorimin e kartave, të cilat u rritën me afërsisht 752% dhe 380%, përkatësisht në vëllim dhe vlerë, në periudhën 2008-2015. Në mënyrë të ngjashme, përdorimi i urdhërtransfertave elektronike është rritur me pothuajse 16 herë në vëllim dhe me më shumë se 4 herë në vlerë, në të njëjtën periudhë reference. Shumica e bankave shqiptare ofrojnë akses në distancë në një llogari bankare dhe shërbime bankare nëpërmjet internetit, si për kompanitë ashtu edhe për individët. Transfertat nëpërmjet *internet banking* - të përcaktuara si urdhërtransferta të iniciuara nëpërmjet internetit - janë rritur mesatarisht me 67% në vit ndërmjet 2012 dhe 2015. Vlen të theksohet se, ndërkohë që numri i çeqeve si mjet pagese ka rënë ndjeshëm në periudhën e vëzhguar, vlera e pagesave filloi të ulet vetëm në vitin 2014 dhe vlera mesatare e çeqeve është pothuajse pesë herë vlerën mesatare të transfertave të kreditit (urdhërtransfertave) në letër.

<sup>28</sup> “Kostot e Pagesave me vlerë të vogël për Përdoruesit në Shqipëri - Një analizë e kahut të kërkesës”, Banka e Shqipërisë, Grupi i Bankës Botërore, 2016.

**Figura 2: Trendi në përdorimin e instrumenteve jo-cash të pagesave  
(vëllimet dhe vlerat e transaksioneve, 2008- 2015)**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

38. Flukset e remitançave të dërguara në Shqipëri, ende kanalizohen në një masë të gjerë përmes shërbimeve të *cash*-it. Kjo është në të njëjtën linjë me trendin global në këtë sektor dhe me faktin se *cash*-i është mjeti kryesor i pagesës në Shqipëri. Arsyeja qëndron në faktin se zakonisht përfituesit e remitançave kanë akses të ulët në llogaritë bankare dhe një preferencë të lartë për t'i marrë remitançat në *cash*. Një arsye tjetër lidhet me koston më të lartë të shërbimeve tradicionale bankare për transfertat me vlerë të ulët, në krahasim me shërbimet më të shpejta dhe më të lira të ofruara nga OTP-të. Së fundi, është e rëndësishme të theksohet se një pjesë shumë e madhe e dërgesave të emigrantëve shpërndahen nëpërmjet kanaleve joformale, e ndikuar kjo edhe nga afërsia gjeografike e Shqipërisë me shumë nga vendet kryesore dërguese.



39. Në disa vende, marrëdhëniet ndërkombëtare midis bankave korrespondente janë shfrytëzuar për ofrimin e shërbimeve të remitancave. Megjithatë, aktualisht, bankave në Shqipëri u duhet ende të përfitojnë nga kjo mundësi në një shkallë të madhe dhe në vend të kësaj alternative, ata zgjedhin të bashkëpunojnë me OTP-të për disbursimin e shumave (p.sh. bankat shërbejnë si agjentë të OTP-ve ndërkombëtare). Gjatë misionit, përfaqësuesit e bankave përmendën dy arsye për moszgjedhjen e alternativës së parë: a) kostoja e lartë e zhvillimit të infrastrukturës së përshtatshme për transfertat ndërkufitare; dhe b) potenciali i kufizuar i bankave për ta mbuluar këtë investim si pasojë e pjesës së vogël të tregut që ato zotërojnë në tregun e remitancave. Megjithatë, disa banka po parashikojnë llogari bankare me karakteristika specifike për transaksione ndërkombëtare që përfshijnë tarifa të favorshme dhe marzhe të këmbimit valutor. Llogari të tilla do të shfrytëzojnë infrastrukturën e brendshme të degëve/filialeve shqiptare të bankave në vendet dërguese dhe do t'u sigurojnë klientëve një mënyrë më efikase dhe më të lirë për të transferuar para. Disa banka në tregun shqiptar tashmë e zotërojnë infrastrukturën e nevojshme për ta ofruar potencialisht këtë lloj shërbimi, në veçanti për transfertat nga Italia, Austria dhe Greqia. Megjithatë, përveç projekteve të përmendura që ende janë në fazat fillestare, ekipi nuk është në dijeni të ndonjë iniciative të madhe të ndonjë banke tregtare që synon rritjen e rolit dhe pjesëmarrjes së bankave në tregun e remitancave.

40. Përveç bankave, 8 institucione financiare jobanka janë të licencuara për të ofruar shërbime të pagesave në Shqipëri. Katër prej tyre janë kryesisht të fokusuar në shërbimet e pagesave vendase (Posta, Easy Pay, M-Pay dhe Pay & Go), 2 ofrojnë transfertat kombëtare dhe ndërkombëtare (Unioni Financiar Tiranë dhe AK Invest) dhe 2 janë institucione të parasë elektronike (M-Pesa/Vodafone dhe Easy Pay me një licencë të veçantë për emetimin e parasë elektronike). Shumica e këtyre subjekteve tashmë janë duke ofruar shërbime të remitancave dhe po eksplorojnë partneritete me bankat dhe institucionet e tjera financiare jobanka, me qëllim rritjen e përdorimit të infrastrukturës për disbursimin e remitancave. Nga ana tjetër, aktualisht institucionet e parasë elektronike nuk ofrojnë shërbime të remitancave ndërkombëtare, edhe pse nuk ka barriera ligjore, sipas verifikimit të bërë nga grupi i punës. Institucionet e parasë elektronike raportojnë se kanë plane për t'i rritur shërbimet e ofruara në të ardhmen. Në veçanti, operatori i *mobile-money* M-Pesa planifikon të prezantojë shërbimin e remitancave ndërkombëtare në vitin 2017.

#### *Rekomandime*

41. ***Shqipëria mbështetet në një infrastrukturë moderne dhe të besueshme, megjithëse jo të plotë, për klerimin dhe shlyerjen e pagesave, të kombinuar me një mbulim të kufizuar të pikave të aksesit. Ekzistojnë mundësi për ta shfrytëzuar më tej këtë infrastrukturë për të zgjeruar mundësinë e përdorimit të transfertave elektronike për dërgimin e remitancave. Në të njëjtën kohë, për të siguruar përdorimin e llogarive të transaksioneve dhe rritjen e qëndrueshme të transaksioneve elektronike, është e domosdoshme që ekosistemi i nevojshëm të zhvillohet. Rekomandimet e mëposhtme paraqesin mundësitë për përmirësime.***

42. ***Bankat në Shqipëri duhet të marrin në konsideratë shfrytëzimin e infrastrukturës së tyre dhe kanaleve elektronike për disbursimin e remitancave. Sot remitancat që transferohen nëpërmjet bankave janë pothuajse ekskluzivisht të kanalizuar përmes llogarive bankare, por ekzistojnë mundësi për përfituesit e remitancave, të cilët nuk kanë akses në shërbimet bankare, që t'i përfitojnë remitancat në mënyrë më të përshtatshme dhe me kosto të ulët. Si shembull, nga shërbimet e dërgimit kartë-me-kartë të ofruara nga rrjetet e mëdha ndërkombëtare të kartave të pagesave përfitojnë bankat, dërguesit dhe përfituesit e remitancave. Këto shërbime, nëse janë të përshtatura posaçërisht për dërgesat e emigrantëve, ofrojnë mundësi për të rritur eficiencën, uljen e koston dhe mundësojnë aplikimin e metodës straight-through-processing për bankat që veprojnë në këtë treg. Përveç kësaj, bankat duhet të eksplorojnë mundësinë e krijimit të partneritetit me bankat e tjera në vendet kryesore dërguese të remitancave dhe, për bankat në të njëjtin grup, të shfrytëzojnë infrastrukturat/rrjetin brenda grupit. Të dyja këto zgjidhje mund të bazohen në llogaritë e thjeshta korrespondente për klerimin dhe shlyerjen e pozicioneve, dhe ofrojnë mundësi për të ofruar një shërbim me***

kosto të ulët për emigrantët dhe familjet e tyre. Në anën e dërguesve të remitancave, shumica e emigrantëve tashmë kanë llogari bankare, ndërsa në anën e pritësve, bankat shqiptare fillimisht mund të ofrojnë instrumente të parapaguara dhe në mënyrë progresive të zgjerojnë nivelin e përfshirjes financiare të pritësve nëpërmjet shitjes së shërbimeve më të sofistikuar.

43. **Institucionet jobanka (institucionet financiare jobanka dhe potencialisht institucionet jofinanciare) mund të luajnë një rol më të madh në ofrimin e pagesave dhe remitancave elektronike në Shqipëri me qëllim përmirësimin e mjedisit.** Këto subjekte në përgjithësi kanë treguar një potencial të madh për të arritur atë segment të popullsisë që nuk është tërhequr ende nga sektori bankar dhe/ose nuk përdor shërbimet elektronike të pagesave. Sidoqoftë, në Shqipëri, institucionet financiare jobanka aktualisht nuk kanë akses (të drejtpërdrejtë ose të tërthortë) në sistemin AECH, dhe për më tepër rregullorja e AECH-së nuk lejon pjesëmarrjen e tyre të drejtpërdrejtë. Ky kufizim mund të çojë në ngadalësimin e zhvillimit të produktit/shërbimit dhe në kosto më të larta që rrjedhin nga mbështetja vetëm në shërbimet e bankave tregtare (shih gjithashtu PP4). Institucionet jofinanciare ndalohen krejtësisht të ofrojnë shërbime të pagesave (shih PP3). Gjithashtu, disa subjekte jobanka kanë një prani të konsoliduar në zonat e largëta, rurale dhe në vende më pak të shërbyera; megjithatë, këto subjekte nuk mund të shfrytëzohen nga bankat si agentë (shih PP3). Kufizimet aktuale reflektohen në faktin se, kur institucionet financiare jobanka veprojnë në tregun e remitancave, ato operojnë pothuajse ekskluzivisht përmes shërbimeve cash - me para në dorë. Përfshirja më e madhe e institucioneve financiare jobanka - duke hequr pengesat përkatëse - mund të çojë në konkurrencë më të lartë dhe në kosto më të lira të shërbimeve për emigrantët dhe familjet e tyre dhe potencialisht sjell rritjen e lëvizjes së remitancave në vend përmes kanaleve të rregulluara.

44. **Lehtësimi i ndërveprimit midis të gjithë emetuesve dhe blerësve në tregun e kartave të pagesave është shumë i rëndësishëm.** Kjo duhet të mbështetet më tej nëpërmjet zhvillimit të një rasti studimi pozitiv të biznesit për të gjithë aktorët e përfshirë në këtë zinxhir. Ka disa mënyra për arritjen e këtyre objektivave. Iniciativa aktuale në Shqipëri për të zhvilluar një skemë kombëtare të pagesave me kartë mund të jetë një zgjidhje. Sidoqoftë, aspektet e rëndësishme të qeverisjes duhet të adresohen për të siguruar pjesëmarrje të gjerë në këtë iniciativë (për detaje të mëtejshme ju lutemi t'i referoheni seksionit 3.3 të raportit "Arritja e përfshirjes efektive financiare në Shqipëri: Në perspektivën e pagesave"). Në të njëjtën kohë, autoritetet duhet të sigurojnë që një infrastrukturë e brendshme e këtij lloji të mos pengojë konkurrencën në tregun e kartave të pagesave në Shqipëri. Për shembull, emetuesit dhe blerësit e kartave duhet të jenë në gjendje të zgjedhin markën e kartave të pagesave që ata duan përkatësisht të emetojnë dhe të pranojnë, si dhe platformën/at e përpunimit që i përshtaten më mirë nevojave të tyre.

45. **BSH-ja duhet të nxisë një iniciativë kombëtare për të shqyrtuar më tej reformat e mundshme në këtë fushë, duke i ftuar bankat dhe institucionet financiare jobanka të paraqesin propozime dhe ide për të rritur dërgimin e remitancave nëpërmjet kanaleve elektronike.** Këto aktivitete mund të ofrohen nëpërmjet Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave (KKSP), ndoshta duke zgjeruar pjesëmarrjen edhe të institucioneve financiare jobanka.

### Parimi i Përgjithshëm 3: Mjedisi ligjor dhe rregullativ

#### **Parimi i Përgjithshëm 3: Shërbimet e remitancave duhet të mbështeten nga një kuadër ligjor dhe rregullativ i shëndoshë, i parashikueshëm, jodiskriminues dhe proporcional, në juridiksionet përkatëse.**

##### *Konteksti*

46. Kuadri ligjor dhe rregullativ përfshin infrastrukturën e përgjithshme ligjore (siç janë ligji në lidhje me kontratat, pagesat, titujt, bankat, marrëdhëniet debitor/kreditor dhe paaftësinë paguese) dhe çdo statut specifik, jurisprudenca, rregullore ose kontrata (p.sh. rregullat e sistemit të pagesave), që lidhen me remitancat.

47. Një kuadër ligjor i shëndoshë dhe i kuptueshëm ndihmon në minimizimin e rreziqeve me të cilat ndeshen të dy palët, ofruesit e shërbimeve të remitancave dhe klientët e tyre. Një kuadër i parashikueshëm ligjor dhe rregullativ është ai në të cilin është e qartë se cilat ligje dhe rregullore janë të rëndësishme, ku ato nuk ndryshojnë shpesh dhe kur zbatohen në mënyrë të qëndrueshme nga autoritetet, duke përfshirë gjykatat. Parashikueshmëria ligjore e rregulltive është një komponent kyç në krijimin e një klime favorizuese për investimet e sektorit privat. Kjo është vendimtare për të rritur konkurrencën dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të remitancave.

48. Termi “jodiskriminues” i referohet një kuadri ligjor dhe rregullativ njësoj të zbatueshëm për të gjithë llojet e ofruesve të shërbimeve të remitancave për sa kohë ata ofrojnë shërbime ekuivalente, pavarësisht linjave të tjera të biznesit të ofruara. Kjo ndihmon në promovimin e një fushe loje të barabartë midis ofruesve të ndryshëm të shërbimeve të remitancave që nxisin konkurrencën në baza të drejta dhe të barabarta. Për shkak se shërbimet e remitancave ofrohen nga lloje të ndryshme ofruesish, një kornizë e cila trajton funksionin më shumë se institucion mund të jetë e dëshirueshme për të minimizuar trajtimin e ndryshëm të ofruesve të shërbimeve të ngjashme. Sidoqoftë, shpesh kjo mund të rezultojë jopraktike: shumë vende tashmë kanë kuadër të ndryshëm ligjor dhe rregullativ që zbatohet për lloje të ndryshme ofruesish të shërbimeve të remitancave dhe ndryshimi do të ishte i vështirë. Për shembull, kuadri ligjor dhe rregullativ mbi bazën e të cilit veprojnë ofruesit bankarë të shërbimeve të remitancave dhe ata jobankarë mund të jetë i ndryshëm. Në këtë rast, parimi bazë mund të plotësohet, duke siguruar që ekzistojnë të drejta dhe detyrime ekuivalente pavarësisht se cili kuadër ligjor zbatohet për një institucion.

49. Shërbimi i remitancave përfshin të paktën dy juridiksione: vendet dërguese dhe vendet pritëse. Kur ofruesit e shërbimeve të remitancave apo agjentët e tyre veprojnë në vende të treta, mund të përfshihen edhe juridiksione të tjera. Ligjet dhe rregulloret në juridiksionet përkatëse duhet të jenë të bazuara në kuadrin ligjor dhe rregullativ që rregullon ofrimin e shërbimeve të remitancave me qëllim që të jenë plotësisht efektive. Autoritetet e një vendi, natyrisht, mund të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në kuadrin ligjor të vendit të tyre. Sidoqoftë, veçanërisht nëse ata janë në dijeni të një çështjeje të rëndësishme ligjore në një vend tjetër në një korridor të rëndësishëm dypalësh, ata mund të duan të punojnë me autoritetet e vendit tjetër në përpjekje për ta zgjidhur çështjen.

50. Ky parim nuk kërkon krijimin e një regjimi të veçantë ligjor për remitancat. Ligjet dhe rregulloret ekzistuese të një vendi mund të ofrojnë përgjigje për kërkesat e parimeve ose ato mund të modifikohen me këtë qëllim. Në veçanti, ofrimi i shërbimeve të remitancave ka gjasa të përfshihet në një kuadër ligjor që mbulon shërbimet e pagesave të një vendi.

##### *Statusi në Shqipëri*

51. Banka e Shqipërisë është autoriteti që rregullon dhe mbikëqyr sistemin kombëtar të pagesave, siç

parashikohet në Ligjin për Bankën e Shqipërisë<sup>29</sup>, në Ligjin për bankat<sup>30</sup>, dhe në Ligjin për sistemin e pagesave<sup>31</sup>. Ajo licencën dhe mbikëqyr ofruesit e ndryshëm të shërbimeve bankare dhe financiare: bankat, shoqëritë e kursim-kreditit (SHKK) dhe institucionet e tjera financiare jobanka. Përkufizimi i "shërbimeve bankare dhe financiare"<sup>32</sup> është dhënë në Ligjin për bankat, së bashku me kriteret relative të licencimit. I njëjti ligj bankar sqaron përkufizimin e institucioneve financiare jobanka dhe liston aktivitetet financiare që ato mund të ofrojnë (neni 54 (2)), ndër të cilat janë edhe shërbimet e pagesave. Në të njëjtën kohë, ligji për veprimtarinë bankare parasheh që licencimi, mbikëqyrja dhe funksionimi i institucioneve financiare jobanka duhet të organizohet përmes rregulloreve. Neni 34.4 i Ligjit nr. 52, 2016 "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre" u mundëson shoqërive të kursim-kreditit të ofrojnë shërbime të pagesave.

52. Rregullorja nr. 01 e vitit 2013 "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka" përcakton kushtet, kërkesat, afatet kohore, dokumentacionin dhe procedurat që duhet të ndjekin institucionet financiare jobanka, për t'u lejuar të ndërmarrin aktivitete specifike, dhe parashikon detyrimin për të njoftuar BSH-në për kryerjen e aktiviteteve të tilla në vend. Kjo rregullore i përcakton institucionet e parasë elektronike si subjekte, të cilat, përveç emetimit të parasë elektronike, lejohen të ofrojnë shërbime të pagesave dhe transferimit të parave, pasi të jenë licencuar nga Banka e Shqipërisë (neni 5 (1) (c)).

53. Miratimi i Ligjit për sistemin e pagesave, në vitin 2013, siguroi bazën e duhur ligjore për funksionimin e sistemeve dhe instrumenteve të pagesave. Ligji përmban konceptet më të rëndësishme në këtë fushë që duhet të mbulohen në nivel statutor, përfshirë finalitetin dhe përvokueshmërinë e pagesave, zbatueshmërinë e skemave të netimit, mbrojtjen e kolateralit financiar të vendosur në sistemin e pagesave në rast të paaftësisë paguese, zbatueshmërinë e transaksioneve me anë të instrumenteve elektronike të pagesave, konfliktin midis ligjeve në rast paftësie paguese dhe trunkimin e çqeve. Ligji krijon hapësira për konkurrencë në treg nëpërmjet pjesëmarrjes së institucioneve financiare jobanka, të cilat lejohen të ofrojnë shërbime pagesash.

54. Shqipëria mori statusin e "vendit kandidat për në BE" më 27 qershor 2014. Si pasojë, BSh-ja dhe rregullatorët e tjerë po punojnë për harmonizimin e legjislacionit vendas me kërkesat e BE-së. Në fushën e pagesave, kjo përfshin përpjekjet e Bankës së Shqipërisë për të arritur objektivat e mëposhtëm specifikë: (i) transpozimin e Direktivës së Rishikuar të Shërbimeve të Pagesave (PSD 2); (ii) përafrimin e mëtejshëm me Rregulloren ECB/214/28 (Rregullorja për kërkesat e mbikëqyrjes për sistemet e pagesave me rëndësi sistematike); dhe, (iii) zbatimin në Shqipëri të "Rekomandimeve për sigurinë e pagesave në internet".

55. Sigurimi i shërbimeve të remitancave përfshihet në Rregulloren nr.70 të vitit 2009 "Për veprimtarinë valutore". Kjo rregullore heq fuqitë e vjetra të BSH-së për kontrollin e flukseve dalëse të kapitalit dhe lejon transferat të pakufizuara (në hyrje dhe në dalje). Ajo përshkruan rregullat për ekzekutimin e "transaksioneve në valutë", përfshirë transaksionet midis rezidentëve dhe jorezidentëve në valutë, si dhe transferimet e njëanshme të aseteve nga dhe në Shqipëri. Transaksionet në valutë të huaj përbëhen nga transaksione të regjistruara në kapital dhe llogari rrjedhëse, nga dhe në Shqipëri. Remitancat konsiderohen transaksione

---

<sup>29</sup>Ligji Nr.8269/1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar.

<sup>30</sup>Ligji Nr. 9662/2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

<sup>31</sup> Ligji Nr. 133/2013, datë 29.04.2013 "Për sistemin e pagesave".

<sup>32</sup> Sipas Ligjit për bankat, "veprimtari bankare" përfaqëson marrjen e depozitave monetare ose fondeve të tjera të kthyeshme nga publiku, si dhe përdorimin e tyre për dhënie dhe huasë ose vendosjen e tyre nën emrin dhe për llogari të vet, si dhe lëshimin e pagesave në formën e parave elektronike. Ndërsa "aktivitetet financiare" përfshijnë: të gjitha llojet e kredive, faktoring-un dhe financimin e transaksioneve komerciale; *leasing*-un financiar, pagesat dhe transfertat e parave; garancitë dhe angazhimet; ndërmjetësimin e parave; tregtimin për llogarinë e një banke ose për llogari të klientëve dhe çdo shërbim këshillimor, ndërmjetësues dhe shërbime ndihmëse financiare të të gjitha aktiviteteve të mësipërme, duke përfshirë referencat dhe analizat e kreditit, investimet dhe hulumtimet dhe këshillat e portofolit; si dhe këshilla për blerjet dhe ristrukturimin dhe strategjinë e korporatave.

korrente<sup>33</sup>. Shërbimet e remitançave mund të sigurohen nga bankat ose institucionet financiare jobanka, sipas licencës së lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

56. Kuadri ligjor dhe rregullativ i përshtatet, në një farë mase, risive teknologjike dhe modelit të biznesit, në fushën e pagesave me vlerë të vogël. Në veçanti, bankat, SHKK-të dhe institucionet financiare jobanka tani lejohen të emetojnë para elektronike. Ligji bankar u ndryshua për të përjashtuar paratë elektronike nga koncepti ligjor i depozitës. Sidoqoftë, emetimi i parave elektronike ende konsiderohet si një aktivitet financiar (si "shërbime të tjera të pagesave"), prandaj emetimi i tyre lejohet vetëm për institucionet financiare. Shqipëria nuk ka një kuadër rregullativ gjithëpërfshirës për agjentët dhe nënagjentët. Ndërkohë që Rregullorja nr. 1 e vitit 2013 i lejon institucionet financiare jobanka, të cilat ofrojnë shërbime pagesash, që të kontraktojnë agjentë për të kryer aktivitete në emër të tyre, nuk ka dispozita të tilla për përdorimin e agjentëve nga bankat. Sipas ndryshimeve në përkufizim, agjentët mund të jenë tani një person fizik ose juridik. Ndryshimet e rregullores së vitit 2016 gjithashtu përcaktojnë se përgjegjësia kryesore për përzgjedhjen dhe identifikimin e agjentëve është e institucioneve financiare jobanka që veprojnë si përgjegjës [neni 5 (6)]. Kjo ndryshon nga dispozitat e mëparshme sipas të cilave nevojitej miratimi i BSH-së për agjentët e përzgjedhur (kapitulli 3). Rregullorja nuk përcakton kërkesa specifike për agjentët, por detyron përgjegjës të sigurojë të dhëna për emrin, numrin e identifikimit, adresën dhe pastërtinë penale të agjentëve tek Banka e Shqipërisë [neni 5 (6)]. Marrëveshjet e ekskluzivitetit për përdorimin e agjentëve nuk janë të ndaluara në mënyrë eksplicite.

57. Në fushën e integritetit financiar, Ligji nr. 9917 i vitit 2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" (në tekstin e mëtejme: Ligji PPP/LFT) siguron kuadrin për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave. Ligji PPP/LFT është ndryshuar dhe integruar me rregulloret përkatëse në zbatim dhe është i zbatueshëm për subjektet e sektorit financiar, si dhe çdo subjekt tjetër të licencuar dhe të mbikëqyrur nga Banka e Shqipërisë, përveç subjekteve të tjera. Legjislati përmban normat përkatëse në këtë fushë, midis të cilave edhe detyrimet lidhur me identifikimin dhe verifikimin e konsumatorëve dhe përpilimin e procedurave të brendshme për identifikimin, regjistrimin, monitorimin dhe raportimin e transaksioneve të klientëve. Rrethanat e mëposhtme kërkojnë kujdesin e duhur ndaj klientit, sipas nenit 4 të ligjit: (i) hapja e një llogarie bankare; (ii) transaksionet mbi një prag të caktuar; (iii) kur ka dyshime për vërtetësinë e të dhënave të identifikimit të marra më parë; dhe, (iv) të gjitha rastet kur, pavarësisht pragjeve të raportimit të parashikuara në nen, ekzistojnë dyshime për pastrim parash ose financim të terrorizmit. Identifikimi i klientit mund të bëhet "nëpërmjet dokumenteve, të dhënave ose informacionit të marrë nga burime të besueshme dhe të pavarura" (neni 4/1).

58. Kuadri ligjor i PPP/LFT është përmirësuar më tej vitet e fundit, nëpërmjet një sërë ndryshimesh të bazuara në një qasje ndaj rrezikut për masat lidhur me Kujdesin e Duhur ndaj Klientit (CDD). Në fushën e remitançave, kjo është shumë e rëndësishme për të gjithë ofruesit e shërbimeve që planifikojnë të zhvillojnë produkte të reja, praktika biznesi dhe kanale shitesë të shpërndarjes. Në këto raste, kompanitë e mbikëqyruara do të duhet të kryejnë një vlerësim për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet që lidhen me aktivitetet e reja. Një kujdes i shtuar duhet të ndiqet për klientët dhe transaksionet me rrezik të lartë dhe secila kompani duhet të caktojë një person përgjegjës për verifikimin e pajtueshmërisë me legjislatin PPP/LFT. OTP-të, si çdo ofrues pagesash, do të duhet të garantojnë që agjentët e tyre janë të përfshirë në programet PPP/LFT dhe që agjentët të zbatojnë të njëjtat masa të brendshme për kujdesin e duhur ndaj klientit, mbajtjen e të dhënave dhe raportimin.

59. Ndryshimet në Rregulloren nr. 44 të vitit 2009 kanë ofruar tregues të qartë për aplikimin e një qasjeje të bazuar në rrezik lidhur me PPP/LFT. Këto ndryshime përshkruajnë procedurat dhe dokumentacionin në

---

<sup>33</sup> Transaksionet korrente përfshijnë "transfertat e lidhura me dërgesat e emigrantëve dhe punonjësve jashtë Republikës së Shqipërisë, dërgesat e tjera për shpenzime jetësore familjare, pensionet, ndihmat financiare për paftësi pune dhe të tjera përfitime sociale, taksat dhe kuotat e anëtarësisë, transfertat që rrjedhin nga bashkëpunimi ndërqeveritar" [neni 7(1)(d)].

fushën e “Njohjes së Klientit” (KYC-*Know Your Customer*), rregullat për mbajtjen e të dhënave, ruajtjen dhe raportimin e tyre tek autoriteti përgjegjës. Rregullorja nr. 44 e vitit 2009 përfshin edhe një seri udhëzimesh që ndihmojnë subjektet e detyruara të vlerësojnë nivelet e rrezikut. Udhëzimet në mënyrë eksplicite tregojnë se në rast të situatave të rrezikut të lartë, kompanitë duhet të aplikojnë një nivel të zgjeruar të modelit “Kujdesi i Duhur ndaj Klientit” (CDD.) Subjektet duhet të konsiderojnë gjithmonë tre kategori rreziku në vlerësimin e tyre: (i) rrezikun gjeografik, (ii) rrezikun e klientit, dhe (iii) rrezikun e produkteve, shërbimeve/transaksioneve dhe marrëdhënieve të biznesit. Udhëzimet ofrojnë një sërë shembujsh në secilën kategori, duke i orientuar në detaje subjektet e detyruara, pa kufizuar lirinë e tyre të veprimit.

60. Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave (DPPP) është njësia e inteligjencës financiare shqiptare. DPPP ka kompetencat për të mbledhur, administruar dhe analizuar raportet e dorëzuara nga palët e interesuara për të parandaluar dhe luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. DPPP ka kompetenca të kërkojë statistika dhe të dhëna nga çdo entitet dhe autoritet mbikëqyrës, si dhe mund të shpërndajë informacion tek autoritetet e zbatimit të ligjit nëse ka dyshime për pastrimin e mundshëm të parave ose financimin e veprave të terrorizmit. DPPP gjithashtu ka një rol mbikëqyrës në pajtueshmërinë e kompanive me dispozitat e Ligjit PPP/LFT dhe bashkëpunon me autoritetet e tjera mbikëqyrëse, në veçanti me BSH-në dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF)<sup>34</sup>. Në vitin 2014, Banka e Shqipërisë dhe DPPP nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit dhe për të forcuar qasjen mbikëqyrëse të bazuar në rrezik.

#### *Rekomandime*

61. ***Duhet të merret parasysh një qasje më funksionale dhe e drejtpërdrejtë në rregullimin e shërbimeve të pagesave.*** *Kuadri ligjor që mbulon sistemet, shërbimet dhe instrumentet e pagesave në Shqipëri është gjithëpërfshirës dhe i jep BSH-së kompetenca të mjaftueshme për të rregulluar, mbikëqyrur sistemin kombëtar të pagesave, përfshirë edhe ofruesit e shërbimeve të pagesave. Miratimi i Ligjit për sistemin e pagesave në vitin 2013 ka ofruar gjerësisht baza më të rëndësishme ligjore për sistemet dhe shërbimet e pagesave; por ende ka hapësirë për zhvillim të mëtejshëm në aspekte që lidhen me inovacionin dhe konkurrencën. Në vazhdim, BSH-ja duhet të marrë në konsideratë miratimin e një qasjeje funksionale në kuadrin rregullativ të shërbimeve të pagesave, duke synuar rregullimin e shërbimeve dhe instrumenteve në vend të subjekteve që i ofrojnë ato, duke nxitur kështu fushën e lojës.*

62. ***Institucionet jofinanciare duhet të lejohen të ofrojnë shërbime të pagesave, me kusht që ato të plotësojnë kërkesat për trajtimin e rreziqeve.*** *Aktualisht shërbimet e pagesave dhe të parasë elektronike mund të ofrohen nga bankat dhe institucionet financiare jobanka, ndërsa institucionet jofinanciare nuk lejohen të ofrojnë shërbime në këtë hapësirë. Rregullat aktuale për licencimin mund të dekurajojnë hyrjen e pjesëmarrësve të rinj në treg, duke kufizuar kështu konkurrencën dhe inovacionin - pavarësisht nga fakti që rregulloret për subjektet financiare jobanka lënë hapësirë për mundësitë e adoptimit, në një farë mase, të teknologjive të reja dhe modeleve të biznesit (p.sh., M-Pesa ka shfrytëzuar rregullat për licencimin e subjekteve financiare jobanka për emetimin e parasë elektronike). Do të ishte e përshtatshme që shërbimet e pagesave të lejohen edhe për institucionet jofinanciare, me kusht që ato të mund të përmbushin kërkesat përkatëse për të ofruar shërbime të shëndosha dhe efikase dhe për të mbrojtur fondet e klientëve, dhe të mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë. Transpozimi i ardhshëm i PSD2 duhet të kontribuojë në arritjen e këtij rezultati.*

63. ***Banka e Shqipërisë duhet të punojë për të rregulluar më tej përdorimin e palëve të treta si agjentë dhe nënagjentë.*** *Në veçanti, përdorimi i agjentëve për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe të remitançave nuk duhet të kufizohet duke iu lejuar vetëm subjekteve financiare jobanka p.sh., bankat do të përfitonin nga ky*

---

<sup>34</sup> Juridiksioni i AMF-së përfshin, ndër të tjera, kompanitë e sigurimeve, fondet e investimeve dhe kompanitë e investimeve, fondet e pensioneve, Bursën e Tiranës dhe ndërmjetësit e letrave me vlerë, regjistrin e letrave me vlerë dhe institucionet depozituese.

model edhe për të zgjeruar mbulimin me disa shërbime bankare bazë. Ndër të tjera, duhet të merren parasysh aspektet e mëposhtme:

- *Institucionet e licencuara duhet të kenë lirinë të përcaktojnë se cilët agjentë do të ofrojnë zgjidhjen më të mirë për aktivitetet dhe biznesin e tyre. Në të njëjtën kohë, Banka e Shqipërisë duhet të përcaktojë kërkesat minimale që agjentët duhet të përmbushin dhe duhet të deklarojë në mënyrë eksplicite se OTP-të do të kenë plotësisht përgjegjësi për çdo veprim të agjentëve të tyre.*
- *BSH-ja duhet të krijojë një regjistër publik të agjentëve.*
- *BSH-ja duhet të ndalojë ose kufizojë sa më shumë të jetë e mundur aplikimin e marrëveshjeve dhe kushteve ekskluzive për përdorimin e agjentëve. Prania e këtyre marrëveshjeve/kushteve mund të lejojë krijimin e një pozite monopoli për disa OTP në komunitete ku ekzistenca e agjentëve të mundshëm është e kufizuar. Problemi është edhe më i rëndësishëm nëse kushtet e ekskluzivitetit aplikohen tek agjentët me rrjete të mëdha (p.sh. Posta, kompanitë e telekomunikacionit ose rrjetet më të mëdha të shitjes me pakicë), pasi ato mund të jenë pika e vetme e aksesit në disa zona të largëta dhe rurale (shih gjithashtu PP4).*

64. **Kuadri shqiptar i PPP/LFT është përmirësuar mjaftueshëm dhe sistemi i përgjithshëm duket të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare.** Integriteti i sistemit financiar është i mbrojtur mirë, dhe i kombinuar me një qasje të bazuar në rrezik, siguron një akses të përshtatshëm në shërbimet financiare të mirërregulluara. Megjithatë, autoritetet duhet të monitorojnë vazhdimisht që kërkesat për pajtueshmëri nuk paraqesin një parakusht shumë të ndërlikuar për remitancat, duke marrë parasysh vlerën e ulët të këtyre transfertave, të cilat nuk paraqesin rreziqe të rëndësishme për integritetin e sistemit.

65. **Qasja bazuar në rrezik e PPP/LFT duhet të përforcohet.** Udhëzimi "Për vlerësimin e rrezikut për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit" i bashkangjitur në Rregulloren 44/2009 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit" mbështet qasjen e nivelit të pajtueshmërisë duke ofruar udhëzime për subjektet e detyruara, se si të përcaktojnë nivelet e rrezikut dhe të zbatojnë modelin e Kujdesit të Duhur ndaj Klientit (CDD). Këto aspekte duhet të përcaktohen më shumë përmes ligjeve dhe rregulloreve të miratuara nga Banka e Shqipërisë, sesa përmes udhëzimeve të thjeshta<sup>35</sup>.

66. **Në anën tjetër, kufizimet maksimale për gjendjen e llogarive të parasë elektronike duhet të korrespondojnë me masat për kujdesin e duhur ndaj klientit (CDD).** Kuptohet që përfundimisht Banka e Shqipërisë i ka eliminuar këto kufizime. Përndryshe, kërkesat për kujdesin e duhur ndaj klientit duhet të jenë proporcionale me rreziqet e mbetura pas zbatimit të kufizimeve për gjendjet e llogarive ose për transaksionet dhe të pasqyrojnë konsideratat mbi koston e ndërmarrjes së kujdesit të duhur ndaj klientit- CDD në krahasim me përdorimin e parasë elektronike.

---

<sup>35</sup> Siç përcaktohet nga BSH në Udhëzimin brenda rregullores 44/2009, "Udhëzimi nuk zëvendëson detyrimet ligjore të subjekteve, por ka për qëllim t'i ndihmojë ata të kuptojnë dhe të menaxhojnë rreziqet me të cilat mund të ndeshen gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre".

## Parimi i Përgjithshëm 4: Struktura e tregut dhe Konkurrenca

### **Parimi i Përgjithshëm 4. Tregu i remitancave duhet të mbështetet nga kushte konkurruese të tregut, duke përfshirë aksesin në infrastrukturën vendase në fushën e pagesave**

67. Eficiencia e shërbimeve të remitancave varet nga një mjedis biznesi konkurrues. Tregjet konkurruese mund të ndikojnë në kufizimin e praktikave monopoliste, në uljen e çmimeve dhe përmirësimin e niveleve të shërbimit. Në disa vende, ose për disa korridore remitanca, kërkesa për këto shërbime mund të jetë e pamjaftueshme për të mbështetur ekzistencën e shumë ofruesve, por edhe këtu, me kusht që tregu të jetë konkurrues - pa pengesa për hyrjen e pjesëmarrësve të rinj - duhet të ndjehen përfitimet e konkurrencës. Shkurajimi i ofruesve të shërbimeve të remitancave nga vendosja e kushteve të ekskluzivitetit ndaj agjentëve, mund të favorizojë konkurrencën. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për një treg lokal, si për shembull një fshat të vogël, ku ka vetëm një agjent të mundshëm (p.sh. dyqani i lagjes) dhe nëse vendoset një kusht ekskluziviteti atëherë do të ekzistojë vetëm një shërbim dërgesash në dispozicion.

68. Subjektet ofruese të shërbimeve të remitancave duhet të jenë në gjendje të shfrytëzojnë infrastrukturën vendase të pagesave, për t'i ofruar këto shërbime. Aksesin në infrastrukturë mund të jetë i drejtpërdrejtë ose i tërthortë. Të dy format e aksesit mund t'u ofrojnë subjekteve, shërbime të përshtatshme të pagesave, dhe avantazhet e disavantazhet e tyre ndryshojnë sipas rrethanave specifike. Cilado qoftë forma e aksesit, është e rëndësishme që ajo të jetë në dispozicion për ofruesit në baza të drejta dhe konkurruese, jo më pak për faktin se ofruesit e shërbimeve të remitancave janë në konkurrencë me njëri-tjetrin dhe aksesin mund të jetë një faktor në aftësinë e tyre konkurruese. Ofruesit e shërbimeve të remitancave pa akses të drejtpërdrejtë në infrastrukturën bazë të pagesave duhet të kenë mundësi të përdorin shërbimet e pagesave të ofruara nga institucionet që kanë akses të drejtpërdrejtë. Institucionet me akses të drejtpërdrejtë në infrastruktura duhet të sigurojnë të gjitha shërbimet përkatëse të pagesave, përfshirë shërbimet e këmbimit valutor, në baza të barabarta për ofruesit e shërbimeve të remitancave.

#### *Statusi në Shqipëri*

69. Sipas të dhënave nga ana e kërkesës, të siguruar nga Grupi i Bankës Botërore, një pjesë e madhe (37%) e flukseve hyrëse të remitancave kanalizohen nëpërmjet shërbimeve dhe sistemeve joformale. Nga ana tjetër, OTP-të kapin 57% dhe bankat 4% të flukseve.

70. Western Union dhe Money Gram, dy operatorët më të mëdhenj ndërkombëtarë të transferimit të parave, dominojnë në ofrimin e shërbimeve të remitancave në Shqipëri. Këta të dy aktualisht përfaqësojnë një duopol, tek i cili përqendrohet pothuajse i gjithë fluksi i remitancave që vjen përmes kanaleve të rregulluara.

- Western Union aktualisht mbështetet në një rrjet disbursues prej rreth 300 vendndodhjesh/pikash, nëpërmjet partneritetit të krijuar me kompaninë vendase Unioni Financiar Tiranë (UFT) dhe bankës së saj, Banka Union. UFT është agjenti ekskluziv i Western Union në vend dhe vepron në emër të OTP-së në zhvillimin e biznesit dhe në krijimin e partneriteteve dhe shërbimeve shtesë. Ndër aktivitetet e ndryshme që po zhvillohen, vlen të përmendet diskutimi i vazhdueshëm me institucionet e tjera financiare jobanka për të krijuar kanale shpërndarëse nëpërmjet *e-wallet* dhe zgjidhjeve të parapaguara.
- Money Gram ka një marrëveshje të ngjashme me AKInvest, e cila përfaqëson OTP-në dhe mbulon zhvillimin e biznesit. Përveç partneritetit të mësipërm, Money Gram ka edhe marrëveshje ekskluzive me pesë banka dhe Postën Shqiptare, me më shumë se 600 pika disbursimi në të gjithë vendin.

71. Operatorë të tjerë ndërkombëtarë të transferimit të parave kanë filluar së fundmi veprimtarinë në vend,



në partneritet me bankat dhe institucionet e tjera financiare jobanka. Midis tyre Ria (aktualisht në partneritet me dy banka dhe dy subjekte financiare jobanka), Coinstar, Universal Payment Transfer, Skrill dhe World Remit. Këto subjekte po e zgjerojnë me shpejtësi praninë e tyre në Shqipëri, duke shfrytëzuar disponueshmërinë e teknologjive të reja dhe instrumenteve inovative të pagesave. Ekipi grumbulloi informacion rreth rritjes së shpejtë të dërgesave të emigrantëve të shpërndara nëpërmjet shërbimit *mobile* dhe vuri në dukje që subjektet shqiptare financiare jobanka janë në kërkim të shërbimeve dhe klientëve të rinj. Në disa raste, disa subjekte financiare jobanka të sapoformuara raportojnë plane të avancuara për të ofruar remitanca nëpërmjet kartave të parapaguara ose duke kredituar llogaritë bankare dhe llogari të tjera transaksioni, gjithmonë brenda mundësive të ofruara nga legjislacioni ekzistues.

72. Disa prej kompanive që operojnë në Shqipëri, në mënyrë aktive aplikojnë kontrata ekskluzive për agjentët e tyre. Posta shqiptare shërben si agjent i një OTP-je kryesore, edhe pse jo ekskluzivisht dhe përmes një pjese të rrjetit të saj. Ekskluziviteti është një aspekt që në përgjithësi zvogëlon konkurrencën në tregun e remitancave në shumë vende të botës. Një periudhë e shkurtër ekskluziviteti mund të justifikohet në raste të caktuara nga nevoja për të investuar në trajnim dhe pajisje, por një justifikim i tillë nuk vlen në rastin e një ekskluziviteti me afat të pacaktuar. Në rrethana të caktuara, kontratat ekskluzive rezultojnë në mbylljen *de facto* të hyrjes në treg nga pjesëmarrës të rinj dhe mund të jetë një faktor që sjell kosto të larta të remitancave.

73. Siç u shpjegua në paragrafët 40 dhe 43 më lart, disa nga institucionet financiare shqiptare jobanka janë të interesuara të sigurojnë akses në infrastrukturën e pagesave me vlerë të vogël, domethënë në sistemin AECH të operuar nga BSH. Për momentin, rregullat e sistemit nuk u lejojnë akses të drejtpërdrejtë institucioneve financiare jobanka, po ashtu edhe kriteret për t'u bërë pjesëmarrës indirekt nuk janë të përcaktuara qartë. Kur bëhet fjalë për institucione financiare jobanka që ofrojnë shërbime të remitancave, mungesa e aksesit në infrastrukturën qendrore të klerimit të pagesave ua rrit më shumë vështirësitë dhe kostot, këtyre të fundit për të modernizuar ofertën e tyre për shërbime. Në një mjedis global ku synohet zvogëlimi i rrezikut (*de-risking*) në të cilin bankat prirën t'u mohojnë subjekteve jobanka shërbimet e lidhura me përshtatjen e rregulloreve (PPP) dhe të cilat mund të pasqyrohen pjesërisht në Shqipëri dhe/ose të ndikojnë në ofruesit shqiptarë jobanka të shërbimeve të remitancave - së bashku me mungesën e aksesit në AECH, agjentët e OTP-ve në Shqipëri që veprojnë në mënyrë të pavarur nga bankat përballen me kufizime në ofrimin e transfertave të dërgesave në llogaritë dhe kartat e pagesave. Bazuar në informacionin e mbledhur, është e vështirë të përcaktohet nëse dhe në çfarë mase këto aspekte rezultojnë në praktika antikonkurruese.

74. Duopoli Western Union - Money Gram mund të jetë gjithashtu një faktor që ndikon në uljen e përdorimit të kanaleve të parregulluara për dërgimin e remitancave. Kjo situatë e tregut për remitanca ndërkombëtare në Shqipëri nuk lë shumë hapësirë për hyrjen e operatorëve të rinj në treg dhe nuk inkurajon inovacionin. Nga ana tjetër, shërbimet më të lira dhe më të volitshme mund të tërheqin një pjesë të flukseve të parregulluara që të kanalizohen në mënyrë formale dhe kështu në mënyrë progresive të zvogëlojnë koston mesatare të dërgimit të remitancave në vend.

#### *Rekomandime*

75. ***Autoritetet duhet të marrin në konsideratë miratimin e masave për të rritur nivelin e konkurrencës në vend dhe për të zgjeruar numrin e lojtarëve në treg, si dhe për të rritur përqindjen e flukseve të remitancave që rrjedhin nëpërmjet instrumenteve të rregulluara. Paragrafët e mëposhtëm ofrojnë disa sugjerime në këtë drejtim.***

76. ***Rekomandohet fuqimisht që kontratat ekskluzive të ndalohen. Këto lloj marrëveshjesh mund të pengojnë ndjeshëm konkurrencën, të rrisin koston e shërbimeve dhe të ndalojë shfrytëzimin e plotë të rrjetit potencial të pikave të aksesit. Do të konsiderohej si një praktikë e mirë nëse ofruesit e shërbimeve të remitancave nuk imponojnë ekskluzivitet për partnerët dhe agjentët e tyre. Në ato vende ku kontratat ekskluzive janë ndaluar, si p.sh. Nigeria, Gana dhe Maroku, ka pasur një rritje të menjëhershme të konkurrencës***

dhe rënie të ndjeshme të kostos së dërgimit të parave në ato vende. Ofruesit e shërbimeve në pronësi të shtetit, që kanë një detyrim të përgjithshëm të shërbimit, në veçanti, duhen të inkurajohen fuqishëm të heqin dorë nga kontratat ekskluzive (si në rastin e Postës shqiptare) dhe të hyjnë në partneritete të shumëfishta me një shumëllojshmëri ofruesish të shërbimeve të remitancave, duke pasur parasysh rolin dhe praninë e tyre institucionale në territorin kombëtar.

77. **BSH-ja duhet të ndryshojë rregullat e hyrjes në sistemin e klerimit, që ajo vetë operon, me qëllim lejimin e pjesëmarrjes së subjekteve financiare jobanka.** Duke lejuar institucionet financiare jobanka të kenë akses të drejtpërdrejtë në infrastrukturën e sistemit kombëtar të pagesave, për aq sa ato përputhen me kërkesat korresponduese të aksesit, kjo do t'i mundësonte plotësisht këtyre subjekteve të zhvillojnë produkte të reja dhe t'u shërbenin më mirë konsumatorëve (shih gjithashtu "Vëzhgimet dhe rekomandimet mbi SKP-në (Sistemin Kombëtar të Pagesave) dhe infrastrukturën bazë të pagesave" në raportin "Arritja e përfshirjes efektive financiare në Shqipëri: një perspektivë e pagesave, dhe gjithashtu PP2)<sup>36</sup>.

78. **Hapësira për konkurrencë duhet të zgjerohet edhe përtej institucioneve financiare jobanka (p.sh., me institucionet jofinanciare).** Lejimi i institucioneve jofinanciare të ofrojnë shërbime të remitancave dhe të pagesave si edhe të emetojnë para elektronike, do të zgjeronte mundësitë për hyrjen e një numri më të madh konkurrentësh në tregun e pagesave (shih PP3).

---

<sup>36</sup> Përveç aksesit të drejtë dhe të hapur në infrastrukturën e pagesave, raporti "Arritja e përfshirjes efektive financiare në Shqipëri: nga perspektiva e pagesave" trajton çështjet në lidhje me aksesin e shërbimit për verifikimin elektronik të identitetit, aktualisht i ofruar nga kompania private "eAleat Identity Services". Raporti pranon se ky shërbim mund të ulë kostot në tregun e pagesave elektronike, veçanërisht kostot e praktikës "Kujdesi i Duhur ndaj Klientit" (CDD) kur hapet një llogari dhe/ose kur aplikohet për shërbime shtesë. Raporti rekomandon që, me qëllim që të ekzistojë një konkurrencë e drejtë, autoritetet në Shqipëri duhet të sigurojnë që të gjithë ofruesit e shërbimeve financiare dhe palët e tjera të jashtme me një qëllim të ligjshëm të jenë në gjendje t'i përdorin këto shërbime në një bazë të drejtë dhe të barabartë. Ndërsa eAleat Identity Services është një kompani private, ajo duhet të operohet kryesisht si një shërbim utilitar, kjo edhe më shumë duke pasur parasysh se burimi i të dhënave mjaft të rëndësishme është Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, i cili është një bazë të dhënash publike.

## Parimi i Përgjithshëm 5: Qeverisja dhe Administrimi i Rrezikut

### **Parimi i Përgjithshëm 5: Shërbimet e remitançave duhet të mbështeten nga praktika të përshtatshme qeverisjeje dhe menaxhimi të rrezikut.**

#### *Konteksti*

79. Qeverisja dhe praktikat e administrimit të rrezikut nga ofruesit e shërbimeve të remitançave mund të përmirësojnë sigurinë dhe saktësinë e shërbimeve të remitançave, si dhe të ndihmojnë në mbrojtjen e konsumatorëve. Strukturat e qeverisjes mund të ndihmojnë ofruesit e shërbimeve të remitançave të përmbushin përgjegjësitë e tyre ndaj klientëve të tyre. Një strukturë qeverisjeje e përshtatshme për një ofrues të vogël të shërbimeve të remitançave, ka të ngjarë të jetë mjaft e ndryshme nga ajo që mund të jetë e përshtatshme për institucionet e mëdha financiare shumëkombëshe. Sidoqoftë, në të dyja rastet, ofruesit e shërbimeve të remitançave duhet të përpiqen të miratojnë standardet për qeverisje të mirë sipas kërkesave ligjore të vendit të tyre dhe të ndjekin praktikat më të mira që mund të jenë zhvilluar për ofrimin e shërbimeve financiare me vlerë të vogël.

80. Siç ndodh në industrinë e pagesave në përgjithësi, edhe industria ndërkombëtare e shërbimeve të remitançave përballë me rreziqe ligjore, financiare, operacionale, reputacionale dhe mashtrim. Në vendosjen e masave të kontrollit për t'u mbrojtur nga këto rreziqe, ofruesit e shërbimeve të remitançave duhet të kryejnë vlerësime të nivelit të rrezikut për të siguruar që masat e propozuara të jenë të përshtatshme për nivelin e rreziqeve dhe madhësinë e biznesit në përgjithësi. Duke vepruar kështu, ata duhet të marrin hapat e duhur për të mbrojtur veten dhe klientët nga rreziqet që rrjedhin nga veprimtaritë e tyre në juridiksione të ndryshme, veçanërisht në ato me mangësi në kuadrin ligjor dhe rregullativ.

#### *Statusi në Shqipëri*

81. Ofruesit e shërbimeve të remitançave të intervistuar gjatë misionit raportuan se kanë sisteme dhe procedura me qëllim adresimin e qeverisjes, pajtueshmërisë dhe menaxhimit të llojeve të ndryshme të rreziqeve - operative, ligjore, financiare dhe të pastrimit të parave/financimit të terrorizmit lidhur me ofrimin e shërbimeve të remitançave. Ofruesit e shërbimeve të remitançave raportuan mbi programet e trajnimit të stafit për të trajtuar rreziqe të ndryshme, përfshirë kujdesin e duhur ndaj klientit, me specialistë të caktuar të ngarkuar me pajtueshmërinë me kërkesat ligjore, sistemet për monitorimin e transaksioneve dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta në përputhje me kërkesat ligjore.

82. BSH-ja ka kompetencat e duhura rregullatore dhe mbikëqyrëse për të monitoruar dhe kontrolluar rrezikun në treg për sistemet e pagesave dhe remitançat. Ligji i Bankës së Shqipërisë<sup>37</sup>, Ligji për bankat dhe Ligji për sistemin e pagesave detajojnë përgjegjësitë e BSH-së për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave, përfshirë emetimin dhe përdorimin e instrumenteve të pagesave.

83. Rregullorja nr. 2 e vitit 2013 "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka" përcakton parametrat për administrimin e rrezikut të subjekteve financiare jobanka, institucioneve të parasë elektronike dhe institucioneve financiare të mikrokredisë, të licencuara për kryerjen e veprimtarisë financiare. Rregullorja kërkon që institucionet e ndryshme të krijojnë një sistem administrimi të rrezikut bazuar në një vlerësim të natyrës, vëllimit dhe kompleksitetit të veprimtarisë së tyre. Një sistem i tillë duhet të

---

<sup>37</sup> Ligji nr.8269/1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 3, përcakton burimin e përgjegjësisë së Bankës së Shqipërisë me qëllim mirëfunksionimin e sistemeve të pagesave në Shqipëri, dhe njëkohësisht e rendit si një nga funksionet kryesore të saj. Në këtë nen përcaktohet se: "Banka e Shqipërisë, në përputhje me objektivin e saj kryesor dhe mbi bazën e tregut të brendshëm bankar, nxit dhe mbështet [...] sistemin e pagesave" dhe që, "Detyrat kryesore të Bankës së Shqipërisë janë si më poshtë: [...] dh) të nxisë funksionimin normal të sistemit të pagesave". Neni 21 i Ligjit për Bankën e Shqipërisë e detajon më tej përgjegjësinë e mësipërme ligjore, në lidhje me organizimin dhe funksionimin e sistemeve të pagesave dhe shlyerjes, si edhe të instrumenteve të pagesave.

përmbajë një sërë politikash, procedurash, rregullash dhe strukturash për administrimin e rrezikut. Rregullorja gjithashtu përcakton për BSH-në një sërë masash të gjera mbikëqyrëse, ndër të cilat ekziston mundësia për të kërkuar pasqyrat financiare nga subjektet financiare jobanka (që veprojnë si ofrues të shërbimeve të remitancave). Një seksion i veçantë i Rregullores trajton administrimin e rrezikut në institucionet e parasë elektronike, ku përfshihen masat për mjaftueshmërinë e kapitalit, mbrojtjen e fondeve të klientëve dhe rreziqet e likuiditetit.

84. Përveç kësaj, në fushën e pagesave ndërkufitare, Rregullorja nr. 70 e vitit 2009 "Për veprimtarinë valutore" parashikon që Banka e Shqipërisë mund të refuzojë kërkesën e autorizimit nga një kompani për të ofruar shërbime bankare dhe/ose financiare ndërkufitare jashtë vendit - përfshirë remitancat - nëse Banka e Shqipërisë konstaton se kompania nuk ka sisteme të përshtatshme për administrimin e rrezikut të lidhur me ofrimin specifik të shërbimeve.

85. Në disa raste, ofruesit e shërbimeve të remitancave të intervistuar gjatë misionit raportuan se përballeshin me disa rreziqe të likuiditetit dhe kredisë për shërbimet e tyre të dërgesave, duke shpërndarë fonde për përfituesit përfundimtarë deri në dy ditë para marrjes së fondeve nga institucioni pagues. Megjithatë, ofruesit e shërbimeve të remitancave nuk raportuan problematika thelbësore në të kaluarën lidhur me rreziqet e likuiditetit dhe kreditit.

#### *Rekomandime*

86. ***Në ofrimin e shërbimeve të remitancave duhet të ruhen standarde të larta për adminiostrimin e qeverisjes dhe llojet e tjera të rreziqeve.*** Nëse kjo nuk përfshihet ende në nismat aktuale, Banka e Shqipërisë duhet të parashikojë konsultime me ofruesit e shërbimeve të remitancave dhe palë të tjera të interesuara në zhvillimin e standardeve të qeverisjes dhe udhëzimeve të administrimit të rrezikut, që synojnë në mënyrë specifike mbrojtjen e integritetit të tregut të remitancave. Misioni i BB-së nuk zbuloi të kishte ndonjë ekspozim ndaj rreziqeve, mjaftueshëm të rëndësishëm për të ngritur shqetësime, por duhet të kihet parasysh se rastet e mundshme të mashtrimit, falimentimit ose ndonjë fenomen tjetër negativ që përfshin shërbimet e dërgesave mund të ndikojnë negativisht në besimin te kanalet e rregulluara/formale të remitancave. Sa i përket ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë dhe likuiditetit të përshkruar më sipër, aktualisht ky ekspozim i shkurtër i fluksit të mjeteve monetare për OTP-të kryesore ndërkombëtare nuk duket shqetësues, por duhet të monitorohet me kujdes, veçanërisht kur lojtarë të tjerë hyjnë në treg.

87. ***Autoritetet duhet të angazhohen edhe në konsultime me industrinë për të mundësuar lehtësimin e zbatimit të praktikave të parandalimit të pastrimit të parave (PPP) dhe luftës kundër financimit të terrorizimit (LFT).*** Konsultimet duhet të synojnë largimin e dyshimeve dhe pasigurive të tregut, si dhe reduktimin e kompleksitetit të procedurave për disa aktorë të tregut. Mund të identifikohen zgjidhje të reja për të balancuar nevojën për të siguruar zbatimin e duhur të legjislacionit pa i larguar shumat e mëdha të transaksioneve nga kanalet e rregulluara/formale. Në këtë drejtim, autoritetet mund të konsiderojnë vendosjen e pragjeve për kërkesa më të ulëta të pajtueshmërisë, bazuar në analizën e riskut të disa kanaleve dhe shërbimeve (d.m.th. shërbimet e bazuara në transaksione elektronike).

## Roli i Ofruesve të shërbimeve të remitancave

### **Roli A: Ofruesit e shërbimeve të remitancave duhet të marrin pjesë aktive në zbatimin e parimeve të përgjithshme.**

#### *Konteksti*

88. Ofruesit e shërbimeve të remitancave duhet të përpiqen të zbatojnë Parimet e Përgjithshme. Ata duhet të përpiqen të ofrojnë shërbime konkurruese që plotësojnë nevojat e klientëve të tyre. Megjithatë, ndërsa konkurrojnë për shërbimet, ofruesit e shërbimeve të remitancave duhet të përpiqen, jo në mënyrë anti-konkurruese, të bashkëpunojnë mbështetur në infrastrukturën bazë për të përfituar nga ekonomitë e shkallës dhe efektet e rrjetit dhe për të zvogëluar kështu kostot e përpunimit.

89. Ofruesit e shërbimeve të pagesave kanë një përgjegjësi të veçantë për të siguruar që, si ata ashtu edhe çdo agjent i tyre, të veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, duke përfshirë kërkesat për PPP/LFT. Ata gjithashtu duhet të zbatojnë procese të përshtatshme të qeverisjes dhe të menaxhimit të rrezikut për të ndihmuar në përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit të shërbimeve të tyre dhe për të përmbushur përgjegjësitë e besueshmërisë ndaj klientëve.

#### *Statusi në Shqipëri*

90. Bankat dhe OTP-të nuk kanë bashkëpunuar sistematikisht për të krijuar produkte dhe mekanizma që mund të shfrytëzojnë infrastrukturën ekzistuese të sistemeve të pagesave. Si rezultat, dërgesat shumë rrallë kalojnë në llogaritë ekzistuese bankare të përfituesve ose disbursohen nëpërmjet kartave të pagesave ose mekanizmave të tjerë elektronikë (*e-wallet* ose llogaritë *mobile*). Kjo pengon disbursimin efikas të flukseve nëpërmjet instrumenteve ekzistuese elektronike. Arsyet për këtë situatë janë të dyfishta: (i) nga njëra anë, bankat ua mohojnë shërbimet agjentëve të OTP-ve në Shqipëri, që do të mundësonin disbursimin e dërgesave në llogari – treguesit dhe implikimet e mundshme të këtyre praktikave në aspektin e aksesit në infrastrukturë dhe konkurrencë janë nënvizuar në PP2 dhe PP4; (ii) nga ana tjetër, OTP-të përmendin si arsye kryesore të mungesës së bashkëpunimit me bankat dhe vazhdimin e kryerjes së shërbimit me para në dorë, pamjaftueshmërinë e kërkesës nga klientët dhe përfitueshmërinë e paqartë të segmentit të synuar. Besimi i kufizuar në sektorin bankar dhe nivelet e ulëta të kulturës financiare mund të jenë gjithashtu një faktor pengues i "bankarizimit" të pritësve të remitancave. Kjo përbën një mundësi të humbur për të promovuar aksesin dhe përfshirjen financiare më gjerësisht (nëpërmjet shitjeve të qëndrueshme të produkteve të tjera financiare).

91. Shumica e bankave krijojnë partneritet me vetëm një OTP ndërkombëtare, duke mos marrë parasysh mundësinë e zgjerimit të portofolit të tyre me kompani të tjera. Kjo ndodh për shkak të mundësisë që OTP-të globale të zbatojnë kontrata ekskluziviteti dhe kështu kufizojnë konkurrencën. Skenari i mësipërm kontribuon në mbajtjen e tarifave të larta për shërbimet e dërgesave, të cilat në anën tjetër ndikojnë në rritjen e përdorimit të kanaleve të paligjshme dhe të parregulluara.

92. Aktualisht nuk ka asnjë shoqatë tregtare të OTP-ve dhe subjekteve financiare jobanka në Shqipëri (këto nuk janë anëtarë as të KKSP). Kjo sjell disa pasoja. Për shembull, autoritetet kanë më pak shanse për të dëgjuar zërin kolektiv të industrisë dhe për t'u konsultuar për ndryshime. Për të marrë informacion mbi çështjet e PPP/LFT, për shembull, OTP-të kërkojnë këshillat e autoriteteve në baza dypalëshe, duke marrë në mënyrë të pashmangshme burime të pakta zyrtare dhe kjo mund të rezultojë ndoshta në interpretime të paqëndrueshme. Aty ku ekzistojnë, shoqatat tregtare mund të kërkojnë nga anëtarët e tyre standarde të larta (të menaxhimit të riskut, mbrojtjes së konsumatorit, etj.) dhe mund të sponsorizojnë përdorimin e një karte klientësh.

#### *Rekomandime*

93. ***Bankat tregtare duhet të jenë më proaktive në ofrimin e shërbimeve për transaksionet e remitancave,***

**ndoshta duke krijuar produkte me kosto të ulët dhe duke synuar arritjen e një niveli më të lartë të përfshirjes financiare për pjesën e popullatës (të përjashtuar) që merr remitanca.** Një bashkëpunim më i fortë me bankat e huaja dhe OTP-të ndërkombëtare mund të rezultojë në klientë potencialë të rinj dhe mundësi për shitje të kryqëzuara të shërbimeve financiare. Megjithatë vlen të theksohet se këto mundësi mund të shfrytëzohen plotësisht vetëm nëse boshllëqet aktuale në mbrojtjen e konsumatorit financiar adresohen nga autoritetet përkatëse për të shmangur praktikatat shfrytëzuese dhe për të siguruar një përfshirje financiare "të përgjegjshme". Paralelisht, bankat duhet të jenë të lidhura ngushtë me përpjekjet për të rritur ndërgjegjësimin për kryerjen e pagesave elektronike<sup>38</sup>.

94. **Zhvillimi i infrastrukturës së pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri do të përfitonte nga një bashkëpunim për infrastrukturën qendrore të klerimit dhe ndarjen e rrjetit.** Duke investuar më shumë në infrastrukturën ndërevepruese të kartave dhe në zgjerimin e pranimit të instrumenteve elektronike të pagesave si kartat dhe paratë elektronike, industria mund të rrisë efikasitetin e pagesave të remitancave, duke reduktuar disa nga kostot që lidhen me këtë biznes (për shembull, menaxhimin e parasë, shlyerjen e pozicioneve përkatëse, etj.). Një përpjekje e tillë do t'u mundësonte ofruesve të shërbimeve të remitancave të konkurrojnë më mirë në shërbimet, pasi pagesat janë një industri rrjeti me eksternalitete të rëndësishme.

95. **Bankat dhe rrjetet tjera të rëndësishme të disbursimit duhet të marrin në konsideratë mundësinë për të zgjeruar partneritetet e tyre me më shumë se një OTP, në kundërshtim me pranimin e kushteve të ekskluzivitetit.** Kjo do të rriste disponueshmërinë e opsioneve të disbursimit në treg, duke u siguruar pritësve të remitancave alternativa më konkurruese.

---

<sup>38</sup> Për më shumë detaje dhe rekomandime shiko raportin "Arritja e përfshirjes financiare efektive në Shqipëri: nga pikëpamja e pagesave".

## Roli i autoriteteve publike

### **Roli B: Autoritetet publike duhet të vlerësojnë veprimet që duhet të ndërmarrin për të realizuar objektivat e politikës publike nëpërmjet zbatimit të parimeve të përgjithshme.**

#### *Konteksti*

96. Kur politikëbërësit publikë vendosin të ndërmarrin veprime në lidhje me remitancat duke zbatuar parimet e përgjithshme, autoritetet përkatëse duhet të kenë kompetenca dhe burime të përshtatshme. Autoritetet publike mund të përdorin mjete të shumta, në varësi të nivelit të përfshirjes që vendosin të kenë ato vetë. Këto mjete përfshijnë monitorimin, dialogun me sektorin privat dhe ofrimin e informacionit për publikun. Autoritetet publike mund të përdorin rregullore për të adresuar dështimet e tregut, por më parë, duhet të krahasojnë përfitimet kundrejt kostove të pajtueshmërisë dhe shtrembërimeve të mundshme të tregut.

97. Kur zbatimi i parimeve përfshin autoritete të shumta vendore, politikëbërësit publikë duhet të sigurohen që politikat e brendshme të koordinohen dhe që autoritetet të bashkëpunojnë në një nivel politikash dhe zbatimi. Bashkëpunimi në nivel ndërkombëtar - qoftë bashkëpunim dypalësh i korridorit, rajonal apo global - mund të jetë gjithashtu i dobishëm.

98. Në rastet kur industria e remitancave ka zhvilluar vetërregullim, industria mund të jetë e pozicionuar mirë për të vetërregulluar standardet e shërbimit. Megjithatë, mbetet përgjegjësi e autoriteteve publike të sigurojë që vetërregullimi të përmbushë standardet e kërkuara për një mjedis të dëshirueshëm.

#### *Statusi në Shqipëri*

99. Banka e Shqipërisë është institucioni që ka përgjegjësinë për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit kombëtar të pagesave. Në fakt, kuadri aktual i jep Bankës së Shqipërisë një përgjegjësi të qartë për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve dhe instrumenteve të pagesave (shih nenin 15 të Ligjit për sistemin e pagesave). Megjithatë, nuk ka dispozita lidhur me rregullimin e shërbimeve të pagesave (dhe remitancave) në veçanti, të kombinuara me një përkufizim të kufizuar të sistemit të pagesave që nuk pasqyron kompleksitetin aktual. Në të njëjtën kohë, meqenëse remitancat janë pagesa ndërkufitare dhe përfaqësojnë një aktivitet financiar, autoritetet e tjera qeveritare kanë një rol në zhvillimin e tregut të remitancave dhe ndër ta sigurisht është Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike<sup>39</sup>, Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave (DPPP), dhe Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit.

100. Banka e Shqipërisë themeloi së fundmi Komitetin Kombëtar të Sistemit të Pagesave (KKSP), qëllimi i të cilit është të mbështesë sigurinë, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e sistemit kombëtar të pagesave në Shqipëri. KKSP nuk ka personalitet juridik dhe vendimet e tij nuk janë të detyrueshme. BSH-ja kryeson KKSP-në dhe anëtarët e tij përfshijnë përfaqësues të ndryshëm të Bankës së Shqipërisë dhe të qeverisë shqiptare, Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe Kryetarin e Komitetit të Pagesave të Shoqatës Shqiptare të Bankave. Pjesëmarrësit e tjerë pa të drejtë vote përfshijnë Sekretariatit e Komitetit (i përbërë nga të paktën një punonjës i Sektorit të Sistemeve të Pagesave, Departamenti i Kontabilitetit dhe Financave dhe i Departamentit Juridik në BSH) dhe Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës Shqiptare të Bankave. Nuk ka përfaqësues të subjekteve financiare jobanka ose OTP-ve në KKSP, edhe pse ata mund të marrin pjesë si vëzhgues në disa nga takimet ku diskutimet trajtojnë fushat përkatëse të biznesit të tyre.

---

<sup>39</sup> Aktualisht Zëvendëskryeministri

## Rekomandime

101. **Banka e Shqipërisë duhet të zgjerojë fushën e kompetencave të saj të mbikëqyrjes për të mbuluar në mënyrë eksplicite shërbimet e pagesave (dhe remitancave).** Shërbimet mund të mbulohen nën mbikëqyrjen e "sistemit kombëtar të pagesave" në përgjithësi, të përkufizuar si "të gjitha shërbimet që lidhen me dërgimin, marrjen dhe përpunimin e urdhrave të pagesës ose transfertave të parave në monedhë vendase ose të huaj, lëshimin dhe menaxhimin e instrumenteve të pagesave, sistemeve të pagesave, klerimit dhe shlyerjes, duke përfshirë ato që përpunojnë letrat me vlerë/titujt, marrëveshjet dhe procedurat që lidhen me ato sisteme dhe shërbime, si dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave, përfshirë operatorët e sistemit, pjesëmarrësit dhe çdo palë të tretë që vepron në emër të tyre, ose si agjent ose nëpërmjet nënkontraktimit të palëve të treta".

102. **Nisur nga nisma e Bankës së Shqipërisë për nxitjen e bashkëpunimit në Sistemin Kombëtar të Pagesave (SKP), KKSP duhet të përfshijë të gjitha palët e interesit në një nivel të barabartë - duke përfshirë edhe hapësirën e remitancave që është një komponent integral i SKP-së.** Banka e Shqipërisë duhet të marrë në konsideratë zgjerimin e pjesëmarrjes në KKSP duke përfshirë si anëtarë me të drejtë vote institucionet financiare jobanka apo subjektet e tjera në fushën e remitancave, si dhe përfaqësuesit e përdoruesve të shërbimeve. Duke pasur parasysh rëndësinë jetike të remitancave të brendshme në ekonominë shqiptare, KKSP mund të përdoret si një forum bashkëpunimi midis autoriteteve kombëtare dhe si një kanal komunikimi dhe konsultimi me sektorin privat. Në kontekstin e KKSP-së, mund të diskutohen çështjet e mëposhtme:

- Zgjerimi i rrjetit për disbursimin e remitancave;
- Krijimi i një grupi pune për shqyrtimin e instrumenteve të pagesave me pakicë për dërgimin elektronik të flukseve të remitancave;
- Diskutime të vazhdueshme dhe përmirësime në fushën e PPP/LFT;
- Mbrojtja e konsumatorëve nëpërmjet një kodi sjelljeje bazuar në industri;
- Dialog me autoritetet në lidhje me çështje dhe rregullore të remitancave.

103. **KKSP-ja mund të përdoret edhe për të zhvilluar dhe zbatuar përgjegjësi dhe afate kohore, përfshirë veprimet e kryera.** Mund të jetë e përshtatshme që KKSP-ja të delegojë përgjegjësinë në lidhje me remitancat tek një nënkomitet i palëve të interesuara, për të cilët rekomandimet e këtij raporti mund të shërbejnë si rend dite për mbledhjen e tyre të parë. Përpjekje të tilla duhet të përafrohen, në masën e duhur, me iniciativat/platformat ekzistuese, siç është Strategjia e Axfendës Dixhitale 2015-2020 e prezantuar nga Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike.

104. **Autoritetet duhet të krijojnë një kuadër formal koordinimi për çështjen e remitancave, ku të përfshihen ministritë e linjës dhe agjencitë qeveritare përkatëse.** Kjo mund të marrë formën e një grupi pune ndër-institucional që realizon takime të rregullta çdo tre muaj ose edhe dy herë në vit. Grupi i punës duhet të synojë nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve publike në nivel politikash dhe zbatimi për të siguruar një kornizë politike të përshtatshme, koherente dhe të koordinuar, në lidhje me shërbimet e remitancave.

105. **Autoritetet shqiptare mund të kërkojnë forma bashkëpunimi me homologët e tyre në vendet dërguese, për të adresuar çështjet që kanë të bëjnë me remitancat ndërkombëtare.**



## I. PLANI I PROPOZUAR PËR VEPRIM DHE HAPAT E MËTEJSHËM

Tabela 10. Veprimet kryesore të rekomanduara për zbatimin e parimeve të përgjithshme

AFATI KOHOR	PRIORITET I	PARIMI I PËRGJITHSHËM	VEPRIMI I PROPOZUAR	REZULTATI I PRITSHËM	NJËSIA PËRGJEGJËSE
Shkurtër/ Mesëm /Gjatë Mesëm	I lartë/ Mesa tar/I ulët I lartë	Parimi i Përgjithshëm 1: Transparenca dhe mbrojtja e konsumatorit	Përfshirja e legjislacionit të duhur në fushën e transparencës dhe mbrojtjes së konsumatorit për shërbimet financiare, duke përfshirë pagesat dhe remitancat.	Rritje e mbrojtjes së klientëve të ofruesve të shërbimeve financiare, duke përfshirë ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe të remitancave; rritje e besimit.	Ministria e Financave, BSH
Shkurtër	Mesatar	Parimi i Përgjithshëm 1: Transparenca dhe mbrojtja e konsumatorit	Vendosja e standardeve të përbashkëta për publikimin e informacionit në fushën e remitancave	Rritje e transparencës dhe publikimi i vazhdueshëm që çon në zgjedhje të mirinformuara dhe ndërgjegjësime më të madh.	BSH, autoritete të tjera të përshtatshme
Mesëm	Mesatar	Parimi i Përgjithshëm 1: Transparenca dhe mbrojtja e konsumatorit	Përpjekje për rritjen e ndërgjegjësimit dhe kulturës financiare, duke përfshirë edukimin për remitancat.	Një kuptim më i mirë i përfitimeve që rrjedhin nga përdorimi i instrumenteve elektronike për kryerjen e pagesave.	BSH, autoritete të tjera të përshtatshme
Mesëm	Mesatar	Parimi i Përgjithshëm 2: Infrastruktura e sistemit të pagesave	Të konsiderohet shfrytëzimi i infrastrukturës së vet (p.sh. për bankat e të njëjtit grup, rrjetin e brendshëm të pronarit)/partneritet dhe instrumentet elektronike (p.sh. parapaguar) për të marrë dhe shpërndarë remitancat.	Produkte bankare më të leverdishme dhe me kosto të ulët për dërgimin/marrjen e remitancave; mbështetje më e vogël në para <i>cash</i> ; përfitime nga përfshirja financiare.	Bankat
Shkurtër - Mesëm	I lartë	Parimi i Përgjithshëm 2: Infrastruktura e sistemit të pagesave	Të hiqen barrierat përkatëse për një rol më të madh të subjekteve financiare jobanka në ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe remitancave (shih gjithashtu PP3 dhe PP4)	Nivele më të larta të konkurrencës dhe kosto më të ulëta për emigrantët dhe familjet e tyre, dhe potencialisht rritje e flukseve të remitancave të pranuar në vend.	BSH

Mesëm	Mesatar	Parimi i Përgjithshëm 2: Infrastruktura e sistemit të pagesave	Lehtësimi i ndërveprimit ndërmjet të gjithë emetuesve dhe blerësve në tregun e pagesave me kartë.	Ndërveprim më i madh; rritje e konkurrencës; përpunim më efikas i transaksioneve me karta.	BSH
Mesëm	Mesatar	Parimi i Përgjithshëm 3: Mjedisi ligjor dhe rregullativ	Të miratojë një përfaqje funksionale për rregullimin e shërbimeve dhe instrumenteve të pagesave	Shërbimet dhe instrumentet rregullohen sipas konsideratave të bazuara në rrezik dhe jo në bazë të subjekteve që i ofrojnë ato.	BSH
Mesëm	I lartë	Parimi i Përgjithshëm 3: Mjedisi ligjor dhe rregullativ	Të lejohet që shërbimet e pagesave të ofrohen edhe nga institucionet jofinanciare, me kusht që ato të mund të plotësojnë kërkesat përkatëse.	Rritje e konkurrencës si rezultat i lojtarëve të rinj; produkte dhe shërbime të reja.	BSH
Shkurtër	I lartë	Parimi i Përgjithshëm 3: Mjedisi ligjor dhe rregullativ	Të rregullohet më tej përdorimi i palëve të treta si agentë dhe nën-agentë, në veçanti: (i) zgjerimi i përdorimit të agentëve në banka; (ii) të përcaktohen kërkesat minimale dhe përgjegjësia e drejtorit/përgjegjësit/OTP-së.	Bankat mund të përfitojnë nga modelet e bazuara në agjent për të zgjeruar mbulimin e disa shërbimeve bazë bankare; rritjen e mbrojtjes dhe besimit të konsumatorëve.	BSH
Mesëm	Mesatar	Parimi i Përgjithshëm 3: Mjedisi ligjor dhe rregullativ	Përforsimi i qasjes së bazuar në rrezik në fushën e PPP/LFT, d.m.th., përcaktimi i nivelit të rrezikut dhe rritja e kujdesit të Duhur ndaj Klientit duhet të disiplinohen nëpërmjet ligjeve dhe rregulloreve dhe jo thjesht nëpërmjet udhëzimeve.	Zbatueshmëria, pajtueshmëria më e lartë.	BSH
Shkurtër	I lartë	Parimi i Përgjithshëm 4: Struktura e tregut dhe konkurrenca	Të ndalohen kontratat ekskluzive; të sigurohet që Ofruesit e Shërbimeve të Remitancave të mos vendosin ekskluzivitet për partnerët dhe agentët e tyre	Rritja e konkurrencës ka të ngjarë të sjellë çmime më të ulëta; Shtrirje më e gjerë e mbulimit me pika shërbimi.	BSH

Shkurtër	I lartë	Parimi i Përgjithshëm 4: Struktura e tregut dhe konkurrenca	Ndryshimi i rregullave të hyrjes në sistemin e automatizuar të klerimit (AECH) për të lejuar pjesëmarrjen e institucioneve financiare jobanka në masën që ato përputhen me kërkesat e pjesëmarrjes.	Subjektet financiare jobanka mund të konkurrojnë në një pozicion të barabartë pa shkaktuar rritje të kostos, duke u shërbyer më mirë klientëve të tyre.	BSH
Mesëm	Mesatar	Parimi i Përgjithshëm 5: Qeverisja dhe menaxhimi i riskut	Të realizohen konsultime për të përmirësuar zbatimin e kërkesave të PPP/LFT, duke përfshirë pragjet për kërkesat më të ulëta të pajtueshmërisë.	Më shumë qartësi, më pak kompleksitet, kosto më të ulëta të pajtueshmërisë.	BSH, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Ofruesit e Shërbimeve të Remitancave
Mesëm	Mesatar	Parimi i Përgjithshëm 5: Qeverisja dhe menaxhimi i riskut	Zhvillimi i standardeve të qeverisjes dhe udhëzimeve të menaxhimit të rrezikut që synojnë në mënyrë specifike mbrojtjen e integritetit të tregut të remitancave.	Standarde më të larta për menaxhimin e qeverisjes dhe lloje të tjera rreziku specifik që lidhen me ofrimin e shërbimeve të remitancave.	BSH në konsultim me Ofruesit e Shërbimeve të Remitancave
Mesëm	I lartë	Roli i ofruesve të shërbimeve të remitancave	Të ofrohen në mënyrë proaktive shërbime të veta për transaksionet e remitancave duke krijuar produkte me kosto të ulët dhe nëpërmjet bashkëpunimit më të fortë me bankat e huaja dhe OTP-të ndërkombëtare.	Nivel më i lartë i përfshirjes financiare për pjesën e (përfshiruar) popullsisë që merr remitancë; rritje e konkurrencës; më pak mbështetje në disburseimin e parave <i>cash</i> .	Bankat
Shkurtër	I lartë	Roli i ofruesve të shërbimeve të remitancave	Të zgjerohet partneriteti me më shumë se një OTP, dhe të kundërshtohen kushtet e ekskluzivitetit.	Mbulim më i gjerë i pikave të aksesit të shërbimeve; konkurrencë më e lartë që sjell uljen e kostos.	Bankat, agjentët e OTP-ve/ rrjetet e disburseimit
Mesëm	Mesatar	Roli i autoriteteve publike	Të rishikohen dhe modifikohen kompetencat mbikëqyrëse për të mbuluar në mënyrë eksplicite shërbimet e pagesave (dhe remitancave)	Bazë ligjore më e fortë dhe më e gjerë për mbikëqyrjen e shërbimeve të pagesave	BSH

Shkurtër	I lartë	Roli i autoriteteve publike	Të përfshihen përfaqësuesit jobankarë të ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe të remitançave si pjesëmarrës në Komitetin Kombëtar të Sistemit të Pagesave.	Përfaqësimi i të gjitha palëve të interesuara në pozita të barabarta në shembullin më të rëndësishëm të bashkëpunimit të sektorëve publik-privat për çështjet e sistemit të pagesave.	BSH
Mesëm	Mesatar	Roli i autoriteteve publike	Ngritja e një kuadri formal koordinimi në fushën e remitançave që përfshijnë të gjitha ministritë përkatëse dhe agjencitë qeveritare.	Bashkëpunim më efikas midis autoriteteve publike në nivelin e politikave dhe implementimit; një kuadër të politikave më koherente dhe të koordinuar për shërbimet e remitançave.	BSH, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike <sup>40</sup> , DPPP, dhe KMK, autoritete të tjera të rëndësishme sipas rastit

<sup>40</sup> Aktualisht Zëvendëskryeministri

